- C. Për më tepër, reduktohet presioni hidrostatik në shtresat ujëmbajtëse poshtë themeleve të strukturave, linjave të shërbimeve dhe gërmimeve të tjera, duke vendosur gjatë gjithë kohës nivelin e ujit në zonën e ndërtimit në një minimum prej 300mm nën sipërfaqen kryesore të gërmimit.

4.4.8.6 Operimi

- A. Para çdo gërmimi nën nivelin e ujit sipërfaqësor, vendoset sistemi në punë për të zvogëluar nivelin e ujit siç kërkohet dhe mbahet në punë vazhdimisht 24 ore në ditë, 7 dite në javë derisa

shërbimet dhe strukturat të jenë ndërtuar në mënyrë të kënaqshme, që përfshin vendosjen e materialeve mbushës dhe drenazhimi nuk është më i nevojshëm.

- B. Vendoset një peshë e përshtatshme materiali mbushës për të mënjeluar efektin e notimit para se të ndërpritet vazhdimi i punimeve të sistemit.

4.4.8.7 Largimi i ujit

Uji i nxjerrë nga gërmimet largohet në një mënyrë të tillë që:

1. Të mos rrezikojë pjesë të punimeve të ndërtimit që janë në vazhdim ose që kanë përfunduar.
2. Të mos i shkaktojë shqetësime strukturave ekzistuese ose punime të tjera në afërsi.
3. Të përputhet me kushtet e lejeve të nevojshme të largimit të ujit.
4. Të kontrollojë largimet: Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e largimin në të gjitha zonat e punimeve duke përfshirë por duke mos u limituar me: gërmimet, rrugët e aksesit, zonat e parkimit, zonat e depozitimit dhe të skelerive. Kontraktori do të sigurojë, të operojë dhe të mirëmbajë të gjitha kanalet, basenet, gropat, tombinot, nivelimet e truallit dhe strukturat e pompimit për të devijuar, mbledhur dhe për të larguar të gjitha ujërat nga zonat ku punohet. I gjithë uji do të nxirret nga zonat ku punohet dhe do të largohet në përputhje me lejet e aplikueshme.

4.4.9 Gërmimet e drenazhimit

1. Kontraktori do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjitha strukturave të kërkuara për të devijuar, të mbledhur, kontrolluar dhe larguar ujin nga të gjitha zonat e ndërtimit dhe gërmimit.
2. Sistemi i drenazhit do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të shmangur përmbytjen e zonave ku punohet.
3. Sistemi i drenazhit do të jetë i rregulluar dhe i alternuar siç kërkohet që të shmange degradimin e sipërfaqes përfundimtare të gërmimit.
4. Kontraktori duhet të përdorë të gjitha masat e kontrollit të erozioneve dhe sedimenteve siç u përshkruara në kete seksion, për të mënjeluar degradimin për shkak të ujit natyror që lidhet me ndërtimin.

Pajisjet e drenazhimit duhet të sigurohen për të hequr dhe për të larguar të gjitha ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore që futen në gërmim, kanale, ose pjesë të tjera të punimeve gjatë ndërtimit. Të gjitha gërmimet do të mbahen të thatë gjatë përgatitjes së nënshtresave dhe në vazhdim derisa të ndërtimi i strukturave apo instalimi i tubit të këtë përfunduar me qëllim që të mos ketë dëmtime nga presionet hidrostetike, notimi ose shkaqe të tjera.

4.4.9.1 Pajisjet rezervë

Të sigurohen të gjitha pajisjet rezervë, të instaluar dhe të gatshme për vendosje të menjëhershme në punë, si të kërkohet për të mbajtur në mënyrë të përshtatshme drenazhimin në një bazë të vazhdueshme dhe në rast se e gjithë pajisja ose një pjesë e saj mund të bëhet e papërshtatshme ose të prishet.

4.4.9.2 Veprimet rregulluese

Nëse kërkesat e drenazhimit nuk janë kënaqur për shkak të papërshtatshmërive ose dështimeve të sistemit të drenazhimit (humbja e shtresa të bazamentit, ose mungesa e stabilitetit të shpateve, ose dëmtimi i bazamentit ose i strukturave), do të kryhen punime të nevojshme për kthimin në gjendjen e mëparshme të bazamentit të themeleve dhe strukturave të dëmtuara që rezultojnë nga papërshtatshmërisë ose dështimet e Kontraktorit, pa kosto shtesë për Investitorin.

4.4.9.3 Dëmtimet

Rregullime të menjëhershme për dëmtimet e objekteve ngjitur për shkak të operacioneve të drenazhimit. Në rast se dëmtimet janë të pa pranueshme nga mbikëqyrësi i punimeve, kontraktori duhet ta ribëjë atë pa kosto shtese për investitorin.

4.4.10 Zonat e karrierve të materialeve

Të gjithë materialet e kërkuar për:

1. mbushjeve të përkohshme
2. agregatet e trashë të thyer dhe rëra për betonin
3. bazamentin e rrugës, shtresat e trotuareve,

mund të merren nga punimet e gërmimit, nëse është e përshtatshme, dhe nga karriera materiale zyrtarisht të autorizuara dhe të treguara nga Kontraktori dhe të verifikuara dhe miratuara nga Mbikëqyrësi. Për këtë, duhet të referohet raportit gjeologjik të përgatitur nga Konsulenti gjatë fazës së projekt zbatimit.

Gjithashtu mund të përdoren (pas përzgjedhjes dhe miratimit të Mbikëqyrësit) edhe materiale të marra nga prishja e objekteve.

4.4.10.1 Gërmimi në zonat e karrierve të materialeve

4.4.10.1.1 Dispozita të përgjithshme në lidhje me karrierat e materialeve

Të gjitha punimet e nxjerrjes së materialeve duhet ti përmbahen kufijve të përcaktuar në Vizatime. Para nisjes së gërmimit të ndonjë karriere materiali, Kontraktori duhet të përgatisë një raport që kërkon miratimin e Mbikëqyrësit, ku do të përfshijë sistemin e ndërtimit të rrugëve si dhe programin e shfrytëzimit të propozuar, duke treguar vendndodhjen, shtrirjen dhe thellësinë e zonës që do të gërmohet, metodat e gërmimit, skemën e kullimit dhe materialin ("output"-in) që mendon se do të marrë.

Zonat e nxjerrjes së materialeve do të shfrytëzohen në një mënyrë të tillë që pastrimi, grumbullimi dhe gërmimi i dherave sipërfaqësore të mos ndodhin në zona që do të shfrytëzohen si karriera materiali.

Gjatë gërmimit të karrierve të materialit, materialet mund të jenë jo të përshtatshme për mbushjet, mbushjet strukturale ose si agregate për sistemet e filtrimit, kullimit apo betonin. Këto materiale nuk do të gërmohen. Nëse ky lloj materiali gërmohet, ai do të ngarkohet në makineri transporti dhe do të hidhet në zonat e përcaktuara të depozitimit dhe / ose do të ruhet për qëllime të rivendosjes në gjendjen e mëparshme të karrierve të materialeve siç të udhëzohet nga Mbikëqyrësi.

Zona e nxjerrjes së materialeve duhet të mbahet e rregullt dhe e kulluar. Në rastet kur gërmohen depozitime të lumenjve nën shtratin e lumit, materiali do të kullohet dhe do të ruhet para vendosjes në vepër dhe ngjeshjes.

4.4.10.1.2 Rivendosja në gjendjen e mëparshme të zonave të karrierve të materialeve

Zonat e karrierve të materialeve do të kthehen në gjendjen e mëparshme duke përdorur materiale të vendosura në vend depozitimit të përcaktuara për këtë qëllim dhe do të ndërtohen duke u bazuar në Vizatime ose siç të përshkruhet nga Mbikëqyrësi.

4.5 Largimi i materialit të gërmuar

Të gjitha materialet e gërmuara të cilët nuk mund të ripërdoren për ndërtimin e argjinaturave ose për mbushje apo kryerjen e ndonjë punime tjetër për projektin, duhet të transportohen në pika depozitimi

mbeturinash jashtë zonës ku punohet në një distance të miratuar nga Mbikëqyrësi dhe nga autoritetet përkatëse lokale.

4.5.1 Përgjegjësia mbi tepricat e materialit të gërmuar

Çdo tepricë materialit të gërmuar do të jetë përgjegjësi e Kontraktorit dhe do të depozitohet në një zonë të përshtatshme jashtë brezit të punimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat mjedisore dhe të miratuar nga Mbikëqyrësi i punimeve. Kostoja e këtij procesi do të jetë tërësisht përgjegjësi e Kontraktorit, i cili do t'i marrë në konsideratë ato në analizën e tij të volumeve të gërmimit.

Në zona urbane, ose në zona e tjera ku depozitimi i përkohshëm brenda brezit të punimeve i materialeve të përshtatshme, mund të jetë jo praktik, Kontraktori do t'i ruajë këto materialet në zona të siguruara nga ai, derisa ato të kërkojnë për ndonjë punim apo derisa të kalojnë në tepricë. Me miratim me shkrim të Mbikëqyrësit, Kontraktori, sipas arsyesimit të tij, mund t'i hedhë materialet në dukje të tepërta, me kusht që çdo pjesë e materialit të depozituar që plotëson kërkesat për mbushjet ose kërkesa të tjera të projektit, të zëvendësohet me material të ngjashëm pa asnjë kosto për Investitorin.

Shpenzimet e ruajtjes së përkohshme të materialit të depozituar do të jenë plotësisht detyrim i Kontraktorit, nuk do të bëhet asnjë pagesë shtesë dhe asnjë kompensim për ndonjë përpunim të këtyre materialeve.

4.5.2 Zonat e depozitimit / hedhjes së materialeve të gërmuara

Përveç rasteve kur në Kontratë është lejuar ndryshe, Kontraktori duhet t'i depozitojë të gjitha tepricat e materialeve të gërmuara, duke përfshirë materialet e papërshtatshme për punimet e projektit, jashtë brezit të punimeve në zonat e lejuara dhe të miratuara paraprakisht. Kontraktori duhet të sigurojë zonat e depozitimit pa ndonjë kompensim shtesë. Ai duhet të hartojë metodologji për depozitimin e materialeve ku duhet të përfshihet dhe identifikimi i zonave të depozitimit. Ky dokument do t'i dorëzohet mbikëqyrësit për miratim të paktën 30 ditë para hapjes së zonave të depozitimit.

Zonat e siguruara nga Kontraktori për depozitimin apo hedhjen e materialeve të gërmuara duhet të jenë larg kufirit të projektit dhe të paktën 100m larg nga rruga me e afërt publike. Gjithsesi, kufiri i 100 metrave mund të mos aplikohet nëse materiali depozitohet në rregull, ngjishet, sistemohet dhe gjelbërohet në përputhje me skemën specifike të projektit dhe të miratuar nga Mbikëqyrësi dhe nga autoritetet përkatëse lokale.

4.6 Kontrolli i punimeve të dheut

Kontraktori duhet të sigurojë laboratorë të certifikuar për të kryer vëzhgime dhe testime të materialeve për punimet e dheut ku të përfshihen pajisjet për nxjerrjen e mostrave dhe për testimet, që të jenë të kënaqshme për Mbikëqyrësin dhe që janë të nevojshme për sigurimin e marrjes dhe të testimit të mostrave të materialeve të dheut.

Në këto pajisje doduhet të përfshihen, por pa u kufizuar në pajisjet e nevojshme për testet e mëposhtëm:

- Analiza granulometrike e dherave
- Përcaktimi i lagështisë së dherave
- Test densiteti me kon rëre
- Testi i ngjeshjes Proctor

Pas miratimit të laboratorit, menyra e marrjes së mostrave dhe perdorimi i pajisjeve të testimeve do t'i paraqitet Mbikëqyrësit në mënyrë që të jenë të kënaqshme dhe të përshtatshme për qëllimin e caktuar.

Tabela 4-2: Vlerat e pritshme të mostrave dhe shpeshtësia

Zëri i Punës	Prova laboratorike	Shpeshtësia e marrjes së mostrave	Vlerat e provës
Tabani i mbushjes	Densiteti i dherave ne vend	Çdo 1000 m ²	90% Mod. AASHTO Dens.
	CBR (e ngopur me ujë)		≥5%
Mbushja	Densiteti i dherave ne vend	Çdo 1000 m ²	90% Mod. AASHTO Dens.
	CBR (e ngopur me ujë)		≥15%
	Moduli i deformimit		≥50 N/mm ²
Shtresa e zhavorrit	Densiteti i dherave ne vend	Çdo 500 m ²	95% Mod. AASHTO Dens.
	Moduli i deformimit		≥80 N/mm ²
	CBR (e ngopur me ujë)		≥20%
	Indeksi i Plasticitetit		≤10
	Përmasa maksimale e kokrrizës		150 mm
	Përçindja e kalimit ne siten Nr. 200 (0.075 mm)		≤35%
Nën baza (Çakëlli)	Densiteti i dherave ne vend	Çdo 500 m ²	95% Mod. AASHTO Dens.
	Moduli i deformimit		100 N/mm ²
	CBR (e ngopur me ujë)		≥45%
	Indeksi i Plasticitetit		≤6
	Përmasa maksimale e kokrrizës		80 mm
Baza (Stabilizanti)	Densiteti i dherave në vend	Çdo 500 m ²	98% Mod. AASHTO Dens.
	Moduli i deformimit		150 N/mm ²
	CBR (e ngopur me ujë)	Çdo 1000 m ²	≥80%
	Përmasa maksimale e kokrrizës		40 mm

Kostoja e sigurimit të objekteve dhe hapësirave të punës përpër testimet dhe marrjen e mostrave përfaqësuese për materialet e dheut do të përfshihet në çmimin njësi të preventivit për punimet e dheut.

Pas provave paraprake, numri dhe tipi i të cilave do të jetë i udhëzuar nga Mbikëqyrësi, në mënyrë që të sigurohet që punimet e ndërtimit po prodhojnë rezultatet e kërkuara, do të kryhet tipi dhe numri minimal i provave të mëposhtme:

- Për mbushje të ngjeshur ose për rimbushje poshtë strukturave:
 - Ngjeshja me dorë: Test densiteti me kon rëre në terren ose një test Proctor për çdo 50m³ material të vendosur.
 - Ngjeshje me rul: një test për çdo 500 m³ material të vendosur.
- Një test i plotë i filtrueshmërisë do të kryhet në laborator për çdo 10 teste dendësie në terren për argjinaturat dhe për mbushjet.

Numri i testeve të mësipërme mund të rritet, ose mund të kërkohen teste të tjera shtesë, nëse kërkohet nga Mbikëqyrësi.

Vendndodhja e testeve në terren do të përkrahjet nga Mbikëqyrësi dhe do të përcaktohet nga Kontraktori në terma pozicionimi, largësia nga rruga ose nga aksi i strukturave dhe kuota mbi fundin.

4.7 Kalimet ne ura dhe kanale

Kontraktorit duhet te siguroje te gjithë kalimet e dhura ne ura te vogla dhe te medha, kalime ne kanale, tombino etj. Te gjitha keto kalime, ura, rruge etj do te mirembahen deri sa te gjitha kerkesat e specifikimeve do te permbushen plotesisht. Kosto e ndertimit, mirembajtjes dhe heqjes se te gjithë

pengesave, rrugeve dhe kalimet nen kete klauzole do te shperndahen ne te gjitha zerat e dhena ne Preventiv.

4.8 Mbushjet

4.8.1 Të përgjithshme

Këtu përfshihen punimet në gurore të miratuara për mbushjet, në kavat e materialeve për zhavorret ranore dhe materialet e papërshkueshme në zonat e treguara në Vizatime, dërgesën e materialeve të specifikuar (nxjerrja nga guroret dhe kavat/gërmimi/përpunimi), ngarkimi / shkarkimi, transporti dhe ngjeshja.

Pjesët e ndryshme të argjinaturave dhe trupit të rrugeve do të ndërtohen nga materialet e përzgjedhura (materialet e përshtatshme) nga gërmimet ose nga guroret ose kavat e materialeve. Materialet e përshtatshme të marra nga gërmimet që kërkohen për punimet e përhershme do të përdoren në mënyrën sa më eficiente që jetë të mundshme.

Ndërtimi i argjinaturave dhe trupit të rrugeve do të kryhet në shtresa horizontale dhe të ngjeshura. Kërkesa për ngjeshjen e nevojshme përkufizohet në terma të një produkti përfundimtar (dendësi) ose me anë të metodave të specifikuar për ngjeshje në varësi të tipit të materialit.

Mbushja me gurë do të shpërndahet me anë të një buldozeri me peshë jo më pak se 150 KN. Materialet e tjera mund të shpërndahen me anë të buldozerëve ose ekskavatorëve si të jetë më e përshtatshme.

Përmasa maksimale e kokrrizave të materialit mbushës nuk duhet të kalojë 2/3 e trashësisë së shtresës së ngjeshur.

Mbushjet mund të përbëhen nga materiale të përshtatshme ose të jo të përshtatshme.

Materialet e përshtatshme do të përdoren për mbushjet e përhershme siç mund të jenë argjinaturat, bazamentet e strukturave, mbushjet për stabilimentet, etj. dhe mbushjet e strukturave ose kanaleve.

4.8.2 Përgatitja e bazamentit nën mbushjen

Asnjë material nuk do të vendoset në bazament para inspektimit dhe miratimit të Mbikëqyrësit për gjendjen e bazamentit. Këtu përfshihet edhe rasti kur do të vendosen mbushje të reja mbi materialet e bazamentit.

Përpara se të bëhet ngjeshja e bazamentit duhet që ai të arrijë lagështinë optimale sipas provës "Proctor" të dalë nga testet laboratorike. Ngjeshja e bazamentit, në dherat me përmbajtje argjile dhe pluhuri duhet të bëhet me rul me gunga për të arritur rezultate më të mira. Ngjeshja duhet të arrijë një vlerë minimale prej 90% të densitetit të thatë të modifikuar sipas AASHTO.

Aty ku hasen materiale më të buta në zonën e bazamentit, do të jetë e nevojshme të kërkohet nga Mbikëqyrësi që të arrihet konsolidimi me anë të çimentimit dhe betonimit.

4.8.3 Realizimi i mbushjeve

Te gjitha materialet e përshtatshme dhe të aprovuara të gërmimit duhet, për sa kohë që ato janë praktike, të përdoren për mbushje dhe punime rruge.

Si kusht kryesor është që përgatitja (apo krijimi) e tabanit të mbushjes të arrijë një fortësi (ngjeshje, densitet) $CBR \geq 5\%$; ose $Es \geq 50 \text{ Mpa}$.

Mbushja gjithandej duhet të ketë një densitet që i referuar standardit AASHTO të modifikuar të jetë maksimumi në të thatë jo me pak se 90% për shtresat e poshtme të ngjeshura, dhe 95% për shtresën e sipërme 30 cm ("subgrade").

Çdo shtresë duhet të ngjishet me lagështinë optimale duke shtuar ose tharë shtresën sipas rastit dhe kërkesës së llojit të materialit që do të përdoret në mbushje të rrugës.

Çdo shtresë e re në mbushje duhet të miratohet nga Mbikëqyrësi, pasi të jetë siguruar se shtresa paraardhëse nuk ka deformacione ose probleme me burime uji apo lagështirë të tepërt.

Shtresat duhet të bëhen me trashësi të ngjeshur jo më shumë se 30cm.

Në rast se pjerrësia natyrale e tokës ku do të vendoset mbushja e kalon 20°, ajo duhet të pritët në forme bermash (shkallësh) mbi të cilat do të ndërtohet mbushja. Çdo bermë pritët ndërkohe që është bërë ngjeshja e shtresës paraardhëse të mbushjes. Përmasat e bermave duhet të jenë të mjaftueshme për të lejuar operimin e makinerive që ndodhen në kantier për vendosjen dhe ngjeshjen e materialit mbushës me një gjerësi minimale 1 m dhe lartësi minimale 0.5m, përveç shkëmbit.

4.8.4 Ngjeshja

Ngjeshja duhet të kryhet sipas një radhe pune të vazhdueshme përgjatë gjithë gjerësisë së shtresës, dhe në gjatësi seksioni e cila duhet të jetë ku është e mundur jo më pak se 300 m, përveç kur udhëzohet ndryshe nga Mbikëqyrësi. Trashësia e çdo shtrese, e matur pas ngjeshjes, nuk duhet të kalojë 200 mm përveç rastit ku specifikohet ndryshe në vizatime ose udhëzohet ndryshe nga Mbikëqyrësi.

Materiali që do të ngjishet duhet të shpërndahet tërësisht sipas gjerësisë dhe trashësisë së shtresës nëpërmjet graider-ave, ose mjeteve të tjera të përshtatshëm, dhe të gjithë gurët ose blloqet me një dimension maksimal më të madh se ½ e trashësisë së specifikuar të ngjeshur të shtresës duhet të thyhen ose të hiqen.

Nëse materiali është shumë i lagësht, për shkak të shirave ose çdo lloj shkaku tjetër, ai duhet të hapet dhe të lihet të thahet derisa përmbajtja e lagështisë të përputhet me specifikimet, përpara procesit të ngjeshjes.

Nëse nevojitet ujë përpara ngjeshjes së materialit, ai duhet ti shtohet atij nëpërmjet boteve të ujit të pajisur me tuba spërkatëse dhe të afta ta shpërndajnë ujin uniformisht mbi sipërfaqen që do të ngjishet. Uji duhet të përzihet plotësisht me materialin që do të ngjishet. Përzierja duhet të vazhdojë derisa të hidhet sasia e nevojshme e ujit dhe të krijohet një përzierje uniforme përpara fillimit të ngjeshjes.

Përmbajtja e lagështisë së materialit pas ngjeshjes duhet të jetë e tillë që të arrihet densiteti i specifikuar.

Kontraktori duhet të sigurojë me shpenzimet e veta punëtorinë e nevojshme dhe pajisjet për kontrollin e lagështisë.

Ngjeshja duhet të kryhet nëpërmjet rulave të sheshtë, me gunga, dinamike, dhe/ose pneumatike. Lloji i rulave që do të përdoren dhe energjia e ngjeshjes duhet të jenë të tilla që të sigurojnë arritjen e densiteteve të specifikuara.

Gjatë ngjeshjes shtresa duhet të mbahet në formën e kërkuar të seksionit tërthor, dhe të gjitha vrimat, rrudhat dhe depresionet duhet të korrektohen vazhdimisht nëpërmjet graider-ave.

Mbushja duhet të arrijë një ngjeshmëri 90% MDD për çdo shtrese, kurse në shtresën finale 95% MDD sipas AASHTO.

4.8.5 Mbushja strukturale

4.8.5.1 Mbushje me material të granular(Tipi 1)

Mbushja strukturale do të përfshijë gurët e shpërthyer ose zhavorret ranore me përmasa 0 – 60 mm. Materiali duhet të jetë i graduar mirë. Përmbajtja maksimale e grimcave të imta (që kalojnë sitën 0.075mm) duhet të jetë 5%. Përmasa maksimale e gurëve duhet të jetë sa 2/3 e secilës shtresë të ngjeshur. Mbushja e kanaleve që lidhen me strukturat dhe nënshtresat për pllakat e betonit, do të quhet mbushje strukturale.

Mbushja do të realizohet me shtresa uniforme, me makineri si grejdera ose makineri të tjera të përshtatshme për shtrimin e sipërfaqeve dhe do të ngjishet në një densitet prej jo me pak se 95% MDD siç specifikohet në EN 13286 – 2:2010.

4.8.5.2 Çakell, 16-32 mm (Tipi 2)

Një shtresë baze e ngjeshure përbërë nga shkëmb i thyer (cakell) me granulometri 16 – 32 mm dhe me një trashësi minimale 100 mm, do të shërbejë si bazë për pllakat e betonit, kudo që tregohet në vizatime ose të vendoset nga Mbikëqyrësi. Një membranë filtruese duhet të ndajë materialin e bazamentit nga pllaka e betonit dhe do të jetë në përputhje me EN 13251:2016 (Gjeotekstilet dhe produktet e lidhura me to. Karakteristikat e kërkuara për përdorime në punimet e dheut, bazamente dhe struktura mbajtëse.), EN 13254:2016 (Gjeotekstilet dhe produktet e lidhura me to. Karakteristikat e kërkuara për përdorime në ndërtimin e rezervuarëve dhe digave.) dhe EN 13256:2016 (Gjeotekstilet dhe produktet e lidhura me to. Karakteristikat e kërkuara për përdorime në ndërtimin e tuneleve dhe strukturave nëntokësore).

Lloji i shkëmbit duhet të jetë i forte dhe i qëndrueshëm. Vlera e gjërryerjes e marrë nga prova Los Angeles nuk duhet të jetë më shumë se 40 në përputhje me EN 1097-8:2013. Materiali i thyer duhet të jetë i pastër dhe pa materiale të dëmshme.

Nënshtresa bazë do të ndërtohet me shtresa uniforme, me makineri si grejdera ose makineri të tjera të përshtatshme për shtrimin e sipërfaqeve dhe do të ngjishet në një densitet prej jo me pak se 95% MDD siç specifikohet në EN 13286 – 2:2010. Ngjeshja minimale do të realizohet me 6 kalime të një ruli vibrues 60 KN.

Nënshtresa e përfunduar duhet të jetë në përputhje me përmasat, pjerrësitë dhe parametrat e tjerë të treguar në Vizatime.

4.8.5.3 Specifikime për realizimin e mbushjes

Ndërtimi i mbushjes do të kryhet me shtresa horizontale dhe duhet të jetë në përputhje me praktikën me të mira moderne. Metodën e vendosjes duhet të jenë të orientuara në menyre të tillë që të arrihet një mbushje sa më të qëndrueshme dhe homogjene, pa shtresëzime apo zona që nuk përmbushin kërkesat e këtyre specifikimeve. Çdo sipërfaqe e realizuar dhe e ngjeshur që ndotet do të gërmohet sërish dhe do të zëvendësohet nga Kontraktori nën udhëheqjen e Mbikëqyrësit.

Tabela 4-3: Specifikimet për realizimin e mbushjes

Materiali	Maksimumi i shtresës ose trashësia e ngritur (mm)	Specifikimet e vendosjes	Energjia për ngjeshje
Material i shtresës bazë të tokës	300 (ose sa të kërkohet për të arritur dendësinë e specifikuar)	Shpërndahet me buldozier ose ekskavator..	Rul vibrues i tërhequr ose i shtytur me peshë minimale 40 KN ose siç specifikohet ndryshe për të arritur një densitet minimal të thatë Proctor 95%

Material filtrues	300	Shpërndahet me buldozier ose ekskavator.	Rul vibrues i tërhequr ose i shtytur me peshë minimale 40 KN. Minimumi 6 kalime.
-------------------	-----	--	--

4.8.6 Tolerancat në zbatim

Përveç rasteve kur miratohet ndryshe, përmasat dhe kuotat e sipërfaqeve të përfunduara të punimeve të dheut nuk duhet të ndryshojnë me shumë se vlerat e paraqitura më poshtë nga ato të specifikuar në Vizatime, ose të udhëzuara nga Mbikëqyrësi,. Megjithatë, matjet duhet të jenë në përputhje me kuotat dhe përmasat teorike.

Tabela 4-4: Tolerancat në ndërtim

Tipi i punimit	Tolerancat vertikale në mm
Gërmimi i dheut	+200
Rregullsia e sipërfaqeve të shpateve të përherëshme të gërmuara	200 mm e matur përgjatë një vije të drejtë 5.0 m
Argjinaturat	1. Materialet e papërshkueshme dhe zonat e filtrimit: ± 50 mm 2. Të gjitha zonat e tjera ± 100 mm
Nën shtresat	± 30 mm

Tolerancat horizontale për gjerësinë e dhënë e zonave të materialeve dhe të përmasave të konstruksioneve në vizatime, duhet të jetë (-0 , +500 mm).

4.8.7 Mbushja e kanaleve të tubacioneve

Mbushja e kanaleve të tubacioneve do të kryhet si më poshtë vijon:

- Tubat dhe elementet e parapërgatitur nuk duhet të jenë subjekt i goditjeve anësore ose forcave shtytëse të ujit.
- Dherat sipërfaqesore dhe materiali mbushës duhet të jetë i ngjeshur për të zvogëluar faktorin e ngarkimit mbi tub.




Figura 4-1: Mbushja e kanaleve

Mbushja e tubit do të përbëhet nga dy tipa materialesh:

1. **Materiali i mbushjes së shtrazit** që përfshin shtratin, mbushjen anësore (ijat) dhe mbushjen fillestare. Shtrati duhet të përbëhet nga një material i thyer grimcor i qëndrueshëm me një

përzierje agregatesh të granular, që do të garantojnë stabilitet të mirë dhe nuk përmbajnë materiale të ricikluara apo të prodhuara artificialisht. Ky material duhet të përdoret për shtratin dhe për mbushjen deri në një lartësi të parashikuar mbi kurorën e tubit. Ky material duhet të ketë granulometrin e duhur dhe duhet të garantojë mbështetjen dhe mbeshtjelljen e tubit. Duhet të jetë rërë e granular mirë, e pastër nga pjesët e padëshiruara, grumbuj dheu ose zhavorre me përmasë jo më të madhe se 20mm.

Tabela 4-5: Granulometria e materialit të mbushjes së shtratit

Përmasa nominale	Përqindja në masë që kalon
20mm	100%
10mm	>50%
0.15mm	0-10%
0.075mm	0-5%

- 2. Materiali mbushës** mund të merret nga gërmimi, nëse është i përshtatshëm, ose nga karriera materiali të miratuara. Materiali i përshtatshëm duhet të jetë i graduar mirë, jo plastik dhe i ngjeshur me shtresa jo me të mëdha se 150mm, me CBR më të madhe se 15% dhe MDD 95%. Përmasa maksimale e grimcave duhet të jetë 100mm. Ngjeshja duhet të kryhet me pajisjettë përshtatshme, në të dyja anët e tubit në të njëjtën kohë, duke mënjanuar goditjet anësore dhe forcat fluskuese dhe duke mos i shkaktuar zhvendosje tubit. Sapo të kenë mbaruar punimet e dheut, duhet të fillojnë punimet e mbushjes, ngjeshja e materialit në shtresa të ndryshme duke përdorur materialet të përshtatshme të dheun që gjendet në terren, pa i shkaktuar dëme tubit.

4.8.8 Shirit Paralajmerues

Jo më thellë se 60cm nën nivelin e sipërfaqes perfundimtare, duhet të vendoset një shirit paralajmërues plastik me tregues të vendndodhjes sipas standardit përkatës në gjatësinë totale për të mbrojtur tubin dhe të mundësojë një zbulim të mëvonshëm. Ngjyra dhe mbishkrimi duhet të jenë sipas qëllimit të synuar. Shiriti paralajmërues duhet të jetë me ngjyrë të shkëlqyeshme dhe të paktën 40 mm i gjerë.



5 PUNIMET ELEKTRIKE

5.1 Sistemi i ndriçimit

Për ndriçimin e këtij projekti do të përdoren ndriçues LED me efikasitet të lartë. Kjo zgjedhje është bërë për të marrë maksimumin e ndriçimit duke ulur konsumin e energjisë. Rrjeti i ndriçimit përbëhet nga një lloj ndriçuesi i vendosur në tavan.

5.2 Specifikat teknike për ndriçuesit

Tabela vijuese jep karakteristikat teknike të ndriçuesit.

	
Prodhuesi	-
Fuqia	45.0 W
Fluksi i ndriçimit	≥ 5000 lm
Voltazhi	220 - 240 V
Frekuenca	50 - 60 Hz
Ngjyra e ndriçimit	4000 K
Efikasiteti i ndriçuesit	≥ 100 lm/W
vlerësimi IP	IP65
Klasa e izolimit	I ose II
Jetëgjatësia (L80/B10)	30 000 h
Temperatura e punës	-15 °C – +35 °C
Indeksi i Renditjes së Ngjyrave (CRI) [Ra]	>80
Certifikimet	CE
Garancia	5 vjet

Për sistemin e ndriçimit, për llogaritjen e fluksit të ndriçimit dhe shpërndarjes simetrike, përdoret ndriçues me të dhënat teknike si më lart. Gjatë zbatimit të projektit, mund të përdoret një ndriçues ekuivalent me karakteristika teknike. Për çdo ndryshim në projekt, është detyra dhe përgjegjësia e kontraktorit të rillogaritë parametrat e ndriçimit.

5.3 Linjat e furnizimit me energji

5.3.1 Qëllimi

Të gjitha telat dhe kabllot duhet të kenë certifikatën e miratimit nga autoritetet lokale relevante dhe certifikatën e fabrikës. Telat duhet të jenë përcjellës bakri të thjeshtë të izoluar (mbuluar) me një shtresë të vetme të PVC-së për tu futur në tuba dhe teva. Në të gjitha rastet kur kablo PVC përfundon në një panel

shpërndarës siguracioni, pajisjet elektrike, etj., duhet të lihet një sasi telash të lira për të lejuar në të ardhmen, heqjen e rikyçjeve në terminal pa i çuar ata të tërhiqen. Kabllot për secilin seksion të instalimit duhet të mbyllen në tuba dhe në sistemin e kutive të lidhjes për atë seksion të veçantë. Heqja e izolimit në kablo të izoluar me PVC duhet të bëhet duke përdorur një mjet të përshtatshëm për heqjen e izolimit, jo një thikë. Telat duhet të jenë të ngjyrosur për identifikim. Ngjyra blu duhet të përdoret për përcjellësit neutralë, Gjelbër/verdhë duhet të përdoret për përcjellësit tokësorë dhe kafe, zi, gri për përcjellësit fazorë. Duhet përdorur ngjyrat e njëjta për lidhjet në të njëjtën fazë të furnizimit për të gjitha instalimet. Të gjitha kabllot duhet të vendosen në mënyrë që të kenë etiketën dhe vulosjen prej plumbi nga prodhuesit ose provën tjetër të origjinës dhe kontraktori duhet të marrë certifikatat e testimit të përhershme të prodhuesit kundrejt një porosie të caktuar, nëse kërkohet nga inxhinieri. Numri i kabllove që do të instalohen në tuba duhet të jetë i mjaftueshëm për të lejuar futjen e lehtë të kabllove pa dëmtuar dhe në asnjë rrethanë të mos marrë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ në Shqipëri. Të gjitha kabllot duhet të kenë certifikatën e miratimit nga autoritetet lokale të rëndësishme dhe certifikatën e fabrikës. Izolimi PVC i kabllove duhet të rezistojë në 600/1000 V, me përcjellësa të thjeshtë bakri të ngrohura të izoluar me PVC dhe me një mantel PVC përfundimtar mbi to. Të gjitha kabllot e futura nëpërmjet tubave duhet të jenë të izoluar me polivinil klorid dhe me përcjellshmëri të lartë. Kabllot duhet të jenë në seksionin minimal të 1.5mm², për tu përshtatur me ngarkesën e qarkut, tolerancën e duhur, për të siguruar limitin e rënies së voltazhit për qarkun përfundimtar. Në të gjitha rastet, duhet të instalohet një telë tokësorë i veçantë. Jo më shumë se tre llamba vendosen në të njëjtin tubë. Ndrëqesit duhet të fiksohen me siguri në tavanin e ambientit, të varur ose drejtpërdrejt në sipërfaqen e tavanit sipas llojit të ndrëqesit dhe rekomandimit të dhënë nga prodhuesi.

Kabllot për pjesën e furnizimit të energjisë duhet të përputhen me standardet, rregullat dhe rregulloret e përmendura në Specifikatën Gjenerale, veçanërisht duke u përputhur me standardet e mëposhtme:

- BS EN 60228: 2005- Përcjellësit e kabllove të izoluar.
- BS EN 50575:2014+A1:2016- Kabllot e fuqisë, kontrollit dhe komunikimit. Kabllot për aplikime të përgjithshme në punime ndërtimore nën kërkesat për reagim ndaj zjarrit.
- BS EN 50399:2011+A1:2016- Metodat e përbashkëta të testimit për kabllot nën kushtet e zjarrit. Matja e lirimit të nxehtësisë dhe prodhimit të tymit në kabllot gjatë testit të përhapjes së flakëve. Aparaturë testimi, procedurat, rezultatet.
- BS EN 60754-2:2014+A1:2020- Testi mbi gazrat që shfaqen gjatë djegies së materialeve nga kabllot. Përcaktimi i aciditetit (me matje të pH) dhe përcjellshmërisë.
- CEI 20-67- Udhë për përdorimin e kabllove 0,6/1 kV.
- CENELEC - HD 308- Identifikimi dhe përdorimi i bërthamave të kabllove fleksibël.
- CEI UNEL 35318- Kabllot e fuqisë, me izolim HEPR (G16), me mbrojtje PVC (R16), me kërkesa të veçanta për performancën e reagimit ndaj zjarrit sipas Rregullores për Produktet e Ndërtimit (CPR) Kabllot e shumta dhe të shumta me përcjellës të përshtatshëm për instalimet fikse me ose pa ekran (brirë ose letër) - Voltazhet nominale U_o/U 0,6/1 kV - Klasa e performancës së reagimit ndaj zjarrit: Cca-s3,d1,a3
- CEI UNEL 35026- Kabllot e fuqisë me izolim elastik dhe termoplastik për voltazhet nominale që nuk e kalon 1000 V a.c / 1500 V d.c. Kapacitetet e vazhdueshme të rrjedhës për kabllot e varura.

5.3.2 Specifikimet teknike të kabllave të furnizimit me energji

Kabulli i furnizimit me energji duhet të jetë i përshtatshëm për instalimet brenda dhe jashtë dhe duhet të rezistojë ndaj kushteve atmosferike. Lloji i kabllave të furnizimit është FG16OR16 0,6/1 kV, me bakër fleksibël i klasës 5, me izolim HEPR të cilin e mbulon PVC i cili ka cilësinë R16.

Gjatë instalimit, duhet të kujdesemi që rrezja i kthesës të jetë $R_k=4XD$.

Të gjithë produktet duhet të jenë të certifikuar dhe të shënuara me "CE".

Tabela 5.1: Karakteristikat teknike të kabullit të furnizimit FG16OR16 0,6/1 kV

Voltazhi nominal U_0/U	600V/1000 (AC)
Voltazhi maksimal	1200V (AC)
Testi i voltazhit	4000 V
Temperatura maksimale e ushtrimit	90°C
Temperatura minimale e ushtrimit	-15°C
Rrezja e kthesës	4D
Seksioni tërthor	1.5/2.5/4/6/10/16/25 mm ²
Manteli	PVC

5.3.3 Lloji i përcjellësve N07V-K

Lloji: Përcjellës elektrik

Certifikata: ISO9001/2000

Voltazhi: N07V-K 240V

Paketa: 100m

Seksioni (mm²) : 1.5; 2.5; 4; 6

Materiali i izolimit: PVC R2

Temperatura e punës: +5°C - +60° C në përcjellës

5.3.4 Linja trefazore kryesore e furnizimit

Të dhënat Teknike:

Tensioni nominal U_0/U : 0.6/1 kV

Frekuenca: 50 Hz

Materiali i përcjellesit: Alumin

Seksioni Tërthor: 25 mm²

Izolimi: PVC

Shtresa e Jashtme: PVC

Testet duhet te kryhen sic specifikohet ne standartet IEC 228, IEC 230, IEC 502, IEC 811, IEC 885 etj.

5.4 Panelat elektrike

5.4.1 Të përgjithshme

Paneli i shpërndarjes do të jetë në përputhje me standardin IEC (pjesët e kontrollit dhe kyçja on-off për voltazh të ulët), të bashkuara me njëra-tjetrën në fabrikë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe kombëtare relevante. Panelat e shpërndarjes do të kenë një vlerë nominale për voltazhin alternativ 230 V dhe normën e rrymës sipas ngarkesës së lidhur duke përfshirë 30 % të ngarkesës rezervë. Paneli kryesor i shpërndarjes do të ndërtohet për punë të sigurtë, të përdorshme dhe të besueshme.

Dizajni dhe konstruksioni i panelit do të jetë i një lloji të ndarë për zonat e jashtme dhe të instaluar në dysheme dhe duhet të jetë me dimensione, vlera nominale dhe vendosje në përputhje me specifikimet teknike, skemën e një linje dhe të prodhuar në përputhje me standardet.

Ngjyrat vijuese do të merren në konsideratë si:

- Faza L1: Kafe, zi, gri
- Neutrali: Blu
- Toka: Gjelbër/verdhë
- Shenja dhe komanda: Gri

Në panel duhet të ketë një hapësirë rezerve për zhvillime të mëtejshme. Kjo hapësirë duhet të jetë 30% e moduleve që janë në përdorim. Lokacionet bosh do të furnizohen me pllaka të zbrazëta. Të gjithë prizat e MCCB do të jenë 230/400 V AC; 50 Hz sipas normave IEC. Brenda derës do të vendoset lista qartësisht e treguar e qarqeve që janë instaluar në panel. Paneli elektrik dhe aksesoret e tij duhet të jenë në përputhje me normat CEI EN 60439-1, IEC 61439-1 dhe IEC 61439-2 dhe fraksionet e tyre. Të gjitha produktet duhet të jenë të certifikuar dhe të shënuara me "CE"

5.4.2 Specifikimet teknike të Panelit

Tabela në vijim ofron specifikimet teknike të panelit të shpërndarjes së energjisë. Të gjitha produktet duhet të jenë të certifikuar dhe të shënuara me "CE".

Tabela 5.2: Karakteristikat teknike të panelit

Voltazhi nominal i punës	230 / 400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Rryma nominale e panelit	40-100A (referohu detajeve)
Niveli i mbrojtjes	IP 67
Voltazhi i izolimit	1000 V
Temperatura e punës	-15°C / +40°C
Kushte klimaterike (t°/RH%)	+ 40°C/83% - 15°C/93%

5.5 Sistemi SCADA

5.5.1 Sistemi SCADA i Stacioneve të Matjes

Zbatimi i instrumenteve dhe kontrollorëve të kompjuterizuar për të mbledhur informacion mbi rrjedhën dhe presionin e ujit, nivelet e rezervuarit, cilësinë e ujit, gjendjen funksionale të sistemit dhe kushtet e alarmit në të gjitha pikat përkatëse të sistemit të furnizimit, do të përmirësojë kontrollin operacional të të gjithë sistemit të shpërndarjes së ujit. (burimet ujore, stacionet e pompimit, rezervuarët, zonat e rrjetit të shpërndarjes)

Menaxhimi i të dhënave bëhet nga një SCADA-System – për Kontrollin Mbikëqyrës dhe Përvetësimin e të Dhënave – i vendosur në një Dhomë Kontrolli të veçantë dhe strategjik (dispeçer qendror) në zyrat e ujësjellësit. Transferimi dhe komunikimi i të dhënave do të bëhet përmes rrjetit të telefonisë celulare GPRS (General Packet Radio Service).

Të gjitha informacionet përkatëse do të shfaqen grafikisht në një stacion pune kompjuteri, Ndërfaqja Njerëz-Makine (HMI). Operatorët do të përdorin HMI për të monitoruar dhe kontrolluar prodhimin dhe shpërndarjen e ujit.

Kriteret minimale për projektimin SCADA do të jenë si më poshtë:

Për funksionet e nënstacionit:

- vlerat e matura online
- vlerat historike të matura
- alarme dhe ngjarje online
- alarmet dhe ngjarjet historike
- shkrimi online i vlerave të procesit

Për komunikimin GPRS

- lidhje e krijuar
- ruajtja e të dhënave në nënstacione nëse ndërpritet lidhja online

Për trajtimin

- konfigurimi i nënstacioneve nga stacioni qendror
- inicim i thjeshtë dhe i shpejtë
- funksione diagnostikuese

Për nënstacionet (konceptimi bazë/minimumi):

- funksionet e stacionit
- vlerat e matura online
- vlerat e matura historike
- alarmet dhe ngjarjet online
- alarmet dhe ngjarjet historike
- shkrimi online i vlerave të procesit
- programi global PLC i kontrolluesit

Për konceptimin e programit themelor (funksionet e stacionit)

- vlerat e matura online
- vlerat e matura historike
- alarme dhe ngjarje online
- alarmet dhe ngjarjet historike
- shkrimi online i vlerave të procesit

Sistemi i rrjetit të ujit do të kontrollohet nga një mbikëqyrje, kontroll dhe marrje e të dhënave plotësisht automatike. Ky sistem SCADA do të kombinohet me një sistem që mundëson funksionimin në modalitetin automatik ose manual.

Funksionimi në modalitetin manual duhet të jetë i mundur nga panelet shpërndarëse pa ndihmën e sistemit SCADA. Më tej, do të jetë e mundur të operohen pompat, valvulat etj. nga stacioni kryesor i PC-së në modalitetin "PC-manual".

Sistemi i plotë SCADA do të përbëhet nga një stacion qendror i PC që komunikon me më shumë PLC të vendosura në panelet e kontrollit në të gjithë rrjetin. PLC (t) do të trajtojnë kontrollin automatik të procesit lokal. Trajtimi i të dhënave dhe ndërfaqja e përdoruesit do të menaxhohet nga stacioni qendror i PC-së.

Sistemi SCADA do të mbajë evidencë të zonave ose periudhave kur kontrolli është kaluar nga automatik në manual në formën e regjistrave të kontrollit; gjithashtu, një dështim i caktuar i PLC do të regjistrohet me kohën e ndodhjes, kohëzgjatjen dhe momentin e rikuperimit.

Në kombinim me çdo PLC do të instalohet një panel ndërfaqe operatori (OIP). Këto panele do të shërbejnë për qëllimin e shikimit të parametrave dhe t'i japin operatorit mundësinë e ndryshimit të parametrave në PLC-në lokale, edhe nëse stacioni qendror i PC-së nuk është në funksion.

Të gjitha PLC-të (nëse më shumë se një) do të ndërlidhen nëpërmjet një rrjeti lokal PLC për të dhënë mundësinë e transferimit të të dhënave nga një PLC në tjetrin, pavarësisht nga stacioni kryesor i PC-së. Një shembull i një sinjali që do të transferohet midis të gjitha PLC-ve është rryma hyrëse.

5.5.2 Sistemi SCADA i komandimit të Pompës së Pusit të Ujit

Qëllimi kryesor i këtij sistemi do të jetë komandimi dhe mbikqyrja e punimit të pompës së pusit të ujit G/24, i cili do të jetë i pozicionuar në fshatin Gradishtë. Furnizimi me energji elektrike i pompës zhytëse do të realizohet nëpërmjet një linje të dedikuar që do të lidhë linjën elektrike tre-fazore të OSHEE me kuadrin elektrik pranë pusit G/24. Kuadri elektrik do të përmbajë dy pjesë kryesore: pjesën e fuqisë ku do të perfshihen mbrojtja ndaj lidhjes së shkurtër dhe lidhjes me tokën, mbrojtja termike e pompës, lëshuesi i drejtëpërdrejtë (kontaktor 3-fazor), butonat START & STOP dhe pjesët ndihmëse; pjesa e dytë përfshin sistemin e kontrollit, i cili përmban modulën e komunikimit GSM/GPRS që lidhet me PLC duke shërbyer si sinjal hyrjeje. Gjithashtu, për të bërë të mundur komandimin në distancë të pompës zhytëse, informacioni do t'i shkojë qendrës së kontrollit SCADA të ujësjellësit në qytetin Lushnjë më qëllim komandimin e saktë dhe furnizimin me energji elektrike të pompës në kohën e duhur. Domethwnw, nw depo do tw jetw i instaluar njw sensor niveli (galixhant) qw do tw lidhet me modulën GSM/GPRS i montuar nw kuadrin e tw dhwnave, sinjali i marrw nga sensori i nivelit do tw transmetohet nw modulën GSM/GPRS tw vendosur nw kuadrin elektrik (pjesa e dytw) dhe ky i fundit do t'i japw informacion PLC-sw pwr gjendjen dhe PLC-ja merr vendim pwr tw komanduar kontaktorin (lwshuesin) nwpwrmjet kontakteve ndihmwse tw lwshuesit. Gjithashtu, komandimi i pompws zhytwse do tw mudwsohet edhe fizikisht nw kuadrin elektrik, i cili do tw realizohet nwpwrmjet butonave START & STOP.

5.5.3 Hardware

Sistemi i harduerit PLC do të përbëhet duke përdorur komponentë nga një sistem industrial i standardizuar. Të gjithë komponentët duhet të jenë nga i njëjti prodhues dhe nga e njëjta linjë produkti.

Sistemi do të jetë një sistem industrial modular me CPU, komunikim, module I/O etj. të montuara në bazamente të standardizuara ose shina DIN. Sistemi duhet të dimensionohet me jo më pak se 30% të kapacitetit rezervë, si dhe në lidhje me memorien dhe fuqinë e CPU-së për çdo lloj hardueri, p.sh. IO-slots, numrin e I/O-ve etj. Komponentët individualë duhet të plotësojnë kërkesat minimale të mëposhtme:

- Njësitë e CPU-së do të kenë kapacitetin për të ekzekutuar programet, të cilat janë të nevojshme për të trajtuar procesin, të lidhura dhe numrin e kapaciteteve rezervë gjithëpërfshirëse të përcaktuara të I/O. CPU-ja do të jetë në gjendje të trajtojë instruksionet aritmetike mbi fjalët (16 bit), fjalët e dyfishta (32 bit) në formatin me pikë lundruese, kontrollorët PID me dalje të vazhdueshme dhe hapëse dhe instruksionet Boolean. Shpejtësia e ekzekutimit duhet të jetë e

shpejtë dhe kapaciteti i memories për programin, kohëmatësit, numëruesit, regjistrat etj. duhet të jetë në një madhësi që një kapacitet rezervë prej 40% do të jetë i disponueshëm pas zbatimit të të gjitha programeve të nevojshme për funksionimin e pjesëve të ndryshme të impiantit. Njësitë e CPU-së duhet të pajisen me lidhjet e nevojshme të integruara për një pajisje programimi të bazuar në PC, dhe me një sistem drite të statusit LED që tregon funksionimin e duhur ose situatat e defektit. Shpejtësia e përpunimit për pjesën e përgjithshme të programit PLC nuk duhet të kalojë 50 mili sekonda dhe 100 milisekonda për kontrollorët P, PI dhe PID.

- Modulet e hyrjes dixhitale duhet të jenë me izolim galvanik midis sinjaleve të procesit dhe PLC elektronike. Inputet duhet të projektohen për të trajtuar tensionin 24 VDC dhe sinjalet e pastra të kontaktit të operuara në 24 VDC. Çdo kanal hyrës duhet të jetë i pajisur me tregues LED të statusit aktual.
- Modulet hyrëse analoge do të jenë në gjendje të trajtojnë sinjale industriale të standardizuara 0-20mA, 4-20mA ose 0-10V. Hyrja duhet të jetë me izolim galvanik ndërmjet sinjaleve të procesit dhe autobusit të brendshëm të komunikimit PLC. Izolimi mund të bëhet nëpërmjet transmetuesve të jashtëm izolues galvanik. Inputet individuale duhet të projektohen për të trajtuar të dy sinjalet që i përkasin transmetuesve me furnizim të integruar dhe transmetuesit që do të furnizohen nga njësitë e jashtme të furnizimit me energji. Pllakat duhet të jenë me konvertues analog në dixhital në bord me rezolucion minimalisht 12 bit
- Modulet e daljes analoge duhet të jenë në gjendje të trajtojnë sinjale industriale të standardizuara 0-20mA, 4-20mA ose 0-10V. Hyrja duhet të jetë me izolim galvanik ndërmjet sinjaleve të procesit dhe autobusit të brendshëm të komunikimit PLC. Izolimi mund të bëhet nëpërmjet transmetuesve të jashtëm izolues galvanik. Inputet individuale duhet të projektohen për të trajtuar të dy sinjalet për aktivizuesit me furnizim të integruar me energji dhe aktivizuesit, të cilët do të furnizohen nga njësitë e jashtme të furnizimit me energji. Modulet duhet të jenë me konvertues në bord dixhital në analog me një rezolucion minimal 12 bit.
- Modulet e komunikimit do të jenë të disponueshme në familjen e produktit dhe do të përdoren për komunikimin me panelet e operatorit dhe të brendshëm ndërmjet PLC-ve të ndryshme.

5.6 Automatët

5.6.1 Të përgjithshme

Automatët e rrymës duhet të ndërtohen dhe të testohen sipas standardeve ndërkombëtare ose kombëtare. Kërkimet e veçorive duhet të jenë në përputhshmëri me funksionin e lidhjes elektromekanike ose elektrike të rrjetit të lidhur. Të gjitha veçoritë dhe standardet duhet të garantohen për lartësinë e dhënë në funksion të pozicionit të instaluar të pajisjes.

5.6.2 Automatët termo-magnetik

Pajisjet që shërbejnë për mbrojtjen nga ngarkesat e tepërta dhe lidhjet e shkurtra janë:

- Automati termo-magnetik 4-polësh (4P). Në këtë automat mbrohen nga ngarkesat e tepërta dhe lidhjet e shkurtra tela, 3 telë i fazave dhe 1 i neutralit. Në rast të dështimit, ndërpret automatikisht telin e fazës dhe telin e neutralit.
- Automati termo-magnetik 2-polësh (2P). Në këtë automat mbrohen nga ngarkesat e tepërta dhe lidhjet e shkurtra 2 tela, 1 telë i fazave dhe 1 i neutralit. Në rast të dështimit, ndërpret automatikisht telin e fazës dhe telin e neutralit.

- Automati termo-magnetik 1-pol + neutral (1P+N). Në këtë automat mbrohen nga ngarkesat e tepërta vetëm teli i fazës. Teli i neutralit futet në automat, por nuk mbrohet. Në rast të dështimit, ndërpret automatikisht telin e fazës dhe telin e neutralit.

5.6.3 Specifikimet teknike të automatëve

Automati termo-magnetik duhet të jetë në përputhje me normat dhe standardet EN 60898, EN 60947-2, EN 61008-1/IEC 61008-1/EN 61008-2-1/IEC 61008-2-1. Të gjitha produktet duhet të jenë të certifikuar dhe të shënuara me "CE".

Tabela 5-3: Karakteristikat teknike të automatit termo-magnetik 2P/1P+N

Voltazhi nominal Un	230/400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Ndërprerja e rrymës në qarkun e shkurtër Icu	4000 V
Testi i Voltazhit	6kA
Numri i ndërprerjeve mekanike	20000
Numri i ndërprerjeve elektrike	10000
Niveli i mbrojtjes	IP 40
Voltazhi i izolimit	500 V

5.6.4 Pajisjet diferencialë

Për mbrojtjen nga lidhjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta, instalohen pajisje diferenciale që vendosen në panelin kryesor. Pajisjet që shërbejnë për mbrojtjen nga kontaktet direkte dhe indirekte do të jenë:

- Diferencial 2 polë (i pastër), për sistemet e fazës një (2P)
- Këto pajisje mundësojnë monitorimin e sasisë së rrymës së hyrjes dhe sasisë së rrymës së daljes. Nëse kjo sasi rryme ka një diferencë më të madh se vlera e kalibruar, pajisja do të ndërpresë furnizimin e energjisë në konsumator. Pajisjet diferenciale kanë 5 veçori pune, siç tregohet në figurën më poshtë. Në varësi të qarkut që duhet të mbrohet, do të zgjidhet karakteristika e punës së pajisjes diferenciale. Për mbrojtjen e linjave të ndriçimit do të përdoren pajisje diferenciale me kurbën "A" dhe të kalibruara në vlerën 0.3 A (300 mA).

5.6.5 Specifikimet teknike të automatëve diferencialë

Automatët diferencialë, duhet të jenë në përputhje me normat dhe standardet EN 60898, EN 60947-2, EN 61008-1/ IEC 61008-1/ EN 61008-2-1/ IEC 61008-2-1. Të gjitha produktet duhet të jenë të certifikuar dhe të shënuara me "CE".

Tabela 5-4: Karakteristikat teknike të automatit diferencialë të pastër 2P

Voltazhi nominal Un	230/400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Testi i Voltazhit	4000 V
Ndërprerja e rrymës së qarkut të shkurtër Icu	6 kA
Numri i ndërprerjeve mekanike	10000
Numri i ndërprerjeve elektrike	5000
Niveli i mbrojtjes	IP 40
Voltazhi i izolimit	440 V

Kategoria e tensionit të lartë	III
Rryma diferenciale	0.03A
Karakteristikat e punës / klasa	A

5.6.6 Specifikimet e prizave

Përshkrimi	Specifikimet
Tensioni i punës	230 V
Rryma nominale	16 A
Frekuenca	50 Hz

5.6.7 5.5.7 Specifikimet e çelësave

Përshkrimi	Specifikimet
Tensioni i punës	230 V
Rryma nominale	10 A
Frekuenca	50 Hz

5.6.8 Specifikimet e UPS

Përshkrimi	Specifikimet
Tensioni i punës në hyrje	170-270 V
Tensioni nominal në dalje	230 V
Frekuenca	50 Hz
Fuqia	1000 VA
Numri i fazave	1
Bateria	Acid
Mbojtja	IP65
Montimi	Në rack

5.7 Tubat dhe aksesoret

Instalimi i tubave do të bëhet nën tavan të futura në tuba të pjerrët PVC; në tavan në kanale PVC. Aksesoret për instalime në tavan janë: tuba të pjerrët PVC me dimensione të ndryshme në varësi të dimensionit dhe numrit të telave që do të futen në to; kuti shpërndarëse; kuti për fiksime të prizave ose çelësave. Të gjitha këto vendosen para pjerrëzimit. Për të kryer instalimet elektrike të futura në tavan, duhet të ndiqet radha e punës në këtë mënyrë: vendoset kaperset, pastaj montohen tubat nepemejt kaeseve dhe brrylave. Tubat

duhet të kenë karakteristika të caktuara; Përshtatshmëria me standardet: EI 23-32; materiali pvc; (rezistent) rezistenca e izolimit: 100 MO; vlerësimi IP: IP40; rezistenca e impaktit: IK08; temperatura e instaluar: -5/60°C.

5.8 Sistemi i Tokëzimit

Siç tregohet në vizatim, do të instalohet një tel FeZn D10mm dhe në çdo pajisje (siç tregohet në vizatim) elektrike do të montohet një elektrodë 50x50x5 cm FeZn me gjatësi L=150cm i cili do të lidhet duke përdorur klambrën me telin FeZn. Elementët e sistemit të tokëzimit duhet të jenë në përputhje me normat, CEI EN 62561, CEI EN 62561-2, CEI 99-3, CEI 64-8, CEI 81-10 and CEI EN 62305-3.

5.8.1 Të dhënat teknike

- Forma e kryqit "X" jo më pak se 50x5mm, H=1.5,
- Çelik i cilësisë DIN 17 100
- Furnizuar me pllakë lidhëse dhe klamër
- Në përputhje me DIN 48 – 452
- Mbështjellje me zink - minimumi 70 mikron.

5.8.2 Identifikimi dhe Paketimi

Elektrodat shufër duhet të jenë në kuti kartoni. Çdo kuti duhet të përmbajë informacion rreth:

- lloji i elektrodave shufër
- dimensionet e shufrës
- emri i prodhuesit
- viti i prodhimit
- pesha bruto
- numri i kutisë




Figura 5.1 Elektroda e Tokëzimit

5.8.3 Specifikimet teknike, aksesorët e lidhjes, kabulli i përcjellësit FeZn dhe elektroda FeZn

Morsetat lidhëse me seksion 40x3 mm për lidhjen e përcjellësit FeZn D10mm me elektrodën e shufrave FeZn, e përshtatshme për tu futur në tokë.



Figura 5.2 Morsetë bashkimi shufër me elektrodë FeZn

5.8.4 Specifikimet teknike, aksesorët e lidhjes së kabullit të përcjellësit FeZn me përcjellës bakri

Klemë inoxi, për lidhjen e dy materialeve të ndryshme. Në njërin anë lidhet me përcjellësin FeZn D 8-10 mm, në anën tjetër lidhet me kabllon e tokës me seksion 4-50mm² që çon në panelin elektrik. Klemë nëpërmjet elementit ndërmjetësues të saj, të bërë nga një pllakë inoxi, mund të heqë ose varësojë materiale të ndryshme si Cu, Al, Fe/Zn dhe inox.



Figura 5.3 Morsetë (bashkuese) bashkimi shufër me përcjellës

Përcjellësi i bakrit për realizimin e sistemit të tokëzimit është si më poshtë:



Figura 5.4 Përcjellësi i Bakrit për Lidhjen e Tokëzimit

Të dhënat teknike:

Materiali: Bakër

Ndërtimi: me shumë fije

Seksioni tërthor: 16 mm²

5.9 Sistemi i IT

5.9.1 Kabllot Cat 6 FTP

Kabllot me performancë për të përmirësuar transmetimin e të dhënave në shpejtësi të lartë, zërat dixhital dhe analog, dhe sinjalet e videove (RGB) në rrjetat lokale. Mbështet standardin Gigabit Ethernet (1000 baseT). Operon në një kapacitet prej 250 MHz. Ekranimi i bakrit të kallajisur ofron mbrojtje kundër EMI dhe shmang humbjen e sinjalit. Cilësitë mekanike të kabullit janë si vijon:

Përcjellësi: Bakër i dendur solid 0.25mm²

Izolimi: Polietilenë i dendur me densitet të lartë

Çifte: 2 përcjellës të izoluar të kthyer së bashku

Ekran: Fletë alumini / poliester e gërshetuar me bakër të kallajisur

Mbështjellës: Kabull PVC / LSZH

Diametri: 7.5 mm nominal

Cilësitë mekanike:

Rrezja e përkuljes: < 8 x Diametri i Kabullit në -20°C

Forca e tërheqjes: 11.5Kgs

Gama e Temperaturave: -20°to +70°C

5.9.2 Kabllot e Fibrws Optike

Fibra Optike do të shërbejë për të marrë dhe dërguar të dhëna në kohë reale. Linja do të jetë e dedikuar dhe interneti do të ofrohet nëpërmjet një ISP (Internet Service Provider) pasi është instaluar linja dhe janë bërë testet e nevojshme.

Të dhënat teknike:

Aplikimi: në mjedis të jashtëm

Materiali i veshjes: HDPE

Modaliteti: Single Mode

Numri i bërthamave të fibrave: 2 copë

5.9.3 Kameran

Kameran duhet të jenë të përshtatshme për instalimet jashtë dhe duhet të rezistojnë kushteve atmosferike. Ato gjithashtu duhet të kenë një rezolucion të lartë dhe teknologjinë 'DORI' për zbulimin, vëzhgimin, njohjen dhe identifikimin e njerzëve. Kameran duhet të jenë të pajisura edhe me teknologjinë PoE (Power over Ethernet) (dhe një switch në të njëjtën kohë). Specifikimet teknike për kamerat jepen në tabelat më poshtë.

Tabela 5.5 Specifikimet Teknike të Kameran Bullet

Përshkrimi	Specifikimet
Fokusi i Largësisë	2.8 to 12 mm
Distanca e vëzhgimit	30 m
Rezolucioni	4MP
Këndi i vëzhgimit	Jo më të vogël se 60°

Pamja e Natës	Po
PoE	Po
Instalimi	i jashtëm
DORI (EN-62676-4)	Po
Softuer i instaluar në kamerë	Jo
Shpejtësia e inçizimit	25 pamje/s
Markimi	CE
Mbrojtja e Hyrjes	IP67
Gama e temperaturës së operimit	-30 °C to +60
Deklarata e Pajtushmërisë	Po
Kalibrimi	vetë-kalibrim automatik
Voltazhi në hyrje	- VAC and PoE+
Ethernet	10/100
Audio paneli	1/1 Kanal për Brenda/për Jashtë
Lagështia	mbi 90%
Garancia	3 vjet

Tabela 5.6 Specifikimet Teknike të NVR.

Përshkrimi	Specifikimet
Numri i kanalet e IP-ve	4
I montueshëm në raft	Po
Kapaciteti për ruajtjen e informacionit video	≥ 6 TB
PoE (Power over Ethernet)	Po
Shikim në kohë reale dhe riprodhim	Po
Mburoja nga rrufeja	Po
Rezolucioni	4MP
Energjia në hyrje	230V AC
HDMI	Po
USB (3.0)	≥ 2
Markimi	CE
Temperatura e punës	+0°C to +40°C
Lagështia e punës	<93% pa kondensim
Memoria e brendshme (opsionale)	4 SATA HDD , kapaciteti për HDD: Maksimalisht 6 TB shpejtësia e suportueshme për HDD: 6 Gb/s
Garancia	3 vjet

Tabela 5.7 Specifikimet Teknike të Kasetës së Rackut.

Përshkrimi	

	Specifikimet
Materiali	Hekur i veshur lyster me bojë kundër ndryshkut
Grada e mbrojtjes	IP67
Grada e mbrojtjes mekanike	IK10
Përmasat	600x600x400 mm
Dera	E patejdukshme, hekuri e lyster me bojë

5.10 Blloku i matjes dhe mbikqyrjes së të dhënave nëpërmjet sistemit SCADA

Sistemi i matjes së presionit, prurjes dhe shpejtësisë së ujit është i përbërë prej 11 stacione matjesh të shpërndara në nyjet kryesore të furnizimit me ujë të fshatrave përkatës. Secili stacion matje do të ketë pjesët dhe pajisjet kryesore të mëposhtme me të dhënat përkatëse.

- Kuadri metalik me përmasa 120x80x30 cm, i montuar në bazament betoni, i bojatisur me bojë gri të hapur dhe me shkallë mbrojtje IP68.
- Moduli fotovoltaiq monokristalin me fuqi të instaluar 200 Wp dhe rendiment jo më pak se 20 %, numri i qelizave jo më pak se 72, kutia e bashkimit me IP 65, Shotcky Diodes 3 copë, mënyra e lidhjes me rrjetin të jëtë me bashkues MC4, të jëtë sipas standardeve ISO dhe certifikuar sipas CE.
- Charge controller (rregullatori i ngarkimit të baterisë) të jëtë i përshtatshëm të pranojë hyrjen e tensionit të modulit fotovoltaiq dhe ngarkimi të baterisë, njëkohësisht të jetë i përshtatshëm për furnizimin me energji të ngarkesës DC që në këtë raast është datalogger dhe matësi elektromagnetik.
- Bateria duhe të ketë parametrat e mëposhtëm:
 - Tipi i baterisë: Litiumi
 - Tensioni nominal: 12.8 V
 - Capaciteti nominal: 50 Ah
 - Numri minimal i cikleve: 4000
- Datalogger duhet të ketë parametrat e mëposhtëm:
 - Brezi i matjes: 0 – 100m (0 – 10 bar) or 0 – 200 m (0 – 20 bar)
 - Saktësia: +/-0.5%
 - Rezolucioni: +/-0.5%
 - GSM Modem me brez frequence 900MHz, 1800MHz / 850MHz, 1900MHz
 - Antenë të integruar
 - Portë seriale
 - Memorie të paktën 128 kB
 - Transmetimi i të dhënave: SMS or GPRS. 15 minuta, 30 minuta, 1 orë, 1 ditë ose 1 javë
 - Rregjistrimi: intervali i rregjistrimit të jetë nga 1 sekondë deri 1 orë
 - Mjedisi i punës: të punojë në mjedise -20°C deri +50°C, IP68
- Automatët (mbrojtje nga mbingarkesa dhe lidhja e shkurtër) duhe të kenë parametrat e mëposhtëm:
 - Numri i polëve: 2P
 - Rryma nominale në 25 °C: 6 A

- Lloji i rrymës: DC
- Teknologjia e njësisë së veprimit: termomagnetik
- Kodi i kurbës së veprimit: C
- Kapaciteti i ndërprerjes: 6 kA Icu në 500 V DC sipas EN 60947-2
- Kategoria e përdorimit: Kategoria A sipas EN 60947-2
- Izolacioni: sipas IEC 60947-2
- Numri i cikleve të veprimit mekanik: më shumë se 20000 cikle
- Numri i veprimeve elektrike: jo më pak barazi se 3000 cikle L/R = 2 ms
- Standardi: EN 60947-2
- Kategoria e mbitensionit: IV
- Përcjellësit DC do të kënë parametrat e mëoshtëm:
 - Materiali përcjellës: Bakër
 - Seksioni tërthor: 1.5; 2.5; 4; 6; 10 mm²
 - Temperatura e punës: -40° C deri +90° C dhe +120° C për mbingarkesa
 - Rrezja maksimale e kthesës: 10 herë e diametrit të kabullit
 - Temperatura maksimale në lidhje të shkurtër: 200°C 5s
 - Tesnioni nominal: [U0/U]: AC 600 / 1.000 V | DC 900 / 1.500 V
 - Tensioni i testimit: AC 6,5 kV / DC 15 kV
 - Ndërtimi: me shumë fije IEC 60228 class 5
 - Izolim: Crosslinked Polietilen (XLPE)
 - Veshja e jashtme: XLPE
 - Zhjarrdurues: po
 - Pa halogjen: po
 - Lehtësisht i përkulshëm, me shumë fije: po

5.11 Linja e furnizimit të pompës zhytëse dhe kuadrit elektrik & kontrollit

Linja e furnizimit me energji elektrike të pompës do të jetë e përbërë nga kabulli trefazor 4x6 mm² shtyllat centrifugale prej betoni, qaforet metalike për kapjen dhe mbështetjen e linjës trefazore. Përveç linjës, pjesë e furnizimit me energji elektrike të pompës zhytëse do të jetë edhe kuadri elektrik i vendosur në bazament prej betoni siç tregohet në detajet elektrike.

Komandimi i pompës dhe nivelit të ijit në depon e re do të realizohet nëpërmjet sistemit të kontrollit të realizuar me PLC dhe sistemin GSM/GPRS. Në kuadrin elektrik do të vendosen automati kryesor për mbrojtjen nga mbingarkesat dhe lidhjet e shkurtra. Më pas do të lidhet llampë treguese dhe paralel me të shkarkues tensioni oër mbrojtjen nga mbitensionet. Paralell me keto do të lidhet një mbrojtje diferenciale, e cila bën të mundur mbrojtjen kundrejt lidhjes me tokën. Në seri me të është lidhur një kontaktor që bën lëshimin e pompës nëpërmjet dhënies së sinjalit komandues në kontaktet ndihmëse nga PLC. Gjithashtu, do të vendoset një njësi për marrjen dhe nënien e sinjaleve, njësi GSM/GPRS. Njëra nga njësitë do të instalohet në panelin e të dhanve në depon e re, e cila do të marrë sinjalin e hyrjes nga galixhanti elektrik, sinalin e daljes do ta transmetojë në kuadrin elektrik të pompës zhytëse, pikërisht te marrësi i njësisë GSM/GPRS in instaluar në këte kuadër. Sinjali i marrë nga kjo njësi është sinjal hyrje në PLC, e cila nëpërmjet algoritmit të programuar me gjuhë shkallë ose skript do të komandojë komutimin e pompës zhytëse.

Të dhënat kryesore të linjës elektrike të tensionit të ulët do të jenë:

- Kabulli trefazor 4x6 mm², linjë ABC

- Standardi i ndërtimit: sipas IEC60502/BS 7889/97
- Përcjellësi: Bakri, me shumë fije, klasi i dytë sipas BS 6360 IEC 60228
- Izolimi: XLPE
- Veshja: PVC
- Rezistenca në 20°C: sipas standadit IEC përkatës
- Temperatura e punës: deri në 90°C në manyrë të vazhdueshme
- Temperatura në mbingarkesë: 130°C/100 orë për vit
- Temperatura maksimale në lidhje të shkurtër: 250°C në 5 s
- Tensioni nominal U₀/U: 0.6/1 kV
- Tensioni maksimal i sistemit: 1.2 kV
- Brezi i temperaturës së instalimit dhe ruajtjes: -5°C to +60°C & -25°C to +70°C
- Kufiri i lejuar i kthesës së kabullit: 10 herë diametrit të kabullit
- Kabulli nga kuadri deri në pompën zhytëse:
 - Rezistent për zhytje në ujë të pijshëm në thellësi deri në 100 m
 - Standardi i përdorur: EN 50363-2-1, EN 60228
 - Kundër zjarrit: po sipas IEC 60332-1-2
 - Rezistent ndaj Ozonit: Po IEC 60811-403
 - Kundër ujit: EN 50525-2-21
 - Të jetë i certifikuar sipas CE
 - Tensionin nominal U₀/U: 0.6/1kV
 - Tensionin i testimit: 4 kV
 - Tensionin maksimal i punës në AC: 0.7/1.2kV dhe 1.8 kV DC
 - Seksioni tërthor: 4x6 mm²
 - Temperatura e punës në gjendje normale: -40°C to 90°C
 - Temperatura maksimale në lidhje të shkurtër: 250°C
 - Rrezja minimale e kthesës: 10 herë e diametrit të kabullit
 - Klasa e përcjellësit: klasa 5, me shumë fije
 - Izolimi: EPR (Ethylene Propylene Rubber)
 - Veshja e jashtme: gomë rezistente ndaj ujit, cilësia EM2

5.11.1 Kuadri elektrik dhe pajisjet e brendshme

Kuadri elektrik do të përdoret për të instaluar sistemin elektrik të furnizimit me energji elektrike të pompës dhe mbrojtjes ndaj mningarkesave dhe lidhjeve të shkurtra; gjithashtu, pjesë e tij do të jetë edhe lëshuesi trefazor direkt dhe pjesët ndihmëse të tij.

- Të dhënat kryesore të kuadrit janë:
 - Materiali: metalik
 - Ngjyra: gri e hapur me bojë metalike
 - Permasat: 600x400x250 mm
 - Shkalla e mbrojtjes: IP68
- Të dhënat kryesore të automatit kryesor janë:
 - Numri i poleve: 4P
 - Standardi i ndërtimit: sipas IEC 60947-2
 - Kategoria e kurbës: C

- Rryma nominale: 25 A
- Lloji i Rrymës: AC
- Teknologjia e njësisë së veprimit: Termo-magnetik
- Kapaciteti i Ndërprerjes: 10 kA
- Frekuenca: 50 Hz
- Stamndardet EN 60947-2, 60898-1, IEC 60898-1, IEC 60947-2
- Numri i cikleve mekanike: 20000
- Numri i cikleve elektrike: 10000 cikle
- Temperatura e punës: -35°C deri në 70 °C
- Kategoria e mbitensionit: IV
- Të dhënat kryesore të automatit mbrojtjes diferenciale janë:
 - Numri i poleve: 4P
 - Standardi i ndërtimit: sipas IEC 60947-2
 - Kategoria e kurbës: C
 - Rryma nominale: 25 A
 - Rryma e rrjedhjes: 0.03 A
 - Lloji i Rrymës: AC
 - Teknologjia e njësisë së veprimit: Termo-magnetik
 - Kapaciteti i Ndërprerjes: 10 kA
 - Frekuenca: 50 Hz
 - Stamndardet EN 60947-2, 60898-1, IEC 60898-1, IEC 60947-2
 - Numri i cikleve mekanike: 20000
 - Numri i cikleve elektrike: 10000 cikle
 - Temperatura e punës: -35°C deri në 70 °C
 - Kategoria e mbitensionit: IV
- Të dhënat kryesore të shkarkuesit të tensionit janë:
 - Standardi: EN 61643-11:2012, iec 61643-11:2011
 - Numri i poleve: 3PO
 - Sistemi i tokëzimit: TNC
 - Tipi: 1+2
 - Tensioni i pinës: 230/400 V AC në 50 Hz
 - Rryma noominale e shkarkimit: 20 kV
 - Rryma maksimale plc
 - Rryma impulsive: 12.5 kA L/PE
 - Tensioni maksimal i punës së vazhdueshme fazë – tokë: 350 V
 - Tensioni maksimal i mbrojtjes: 1.5 kV Numri i poleve: 4P
 - Standardi i ndërtimit: sipas IEC 60947-2
 - Kategoria e kurbës: C
 - Rryma nominale: 25 A
 - Lloji i Rrymës: AC
 - Teknologjia e njësisë së veprimit: Termo-magnetik
 - Kapaciteti i Ndërprerjes: 10 kA
 - Frekuenca: 50 Hz
 - Stamndardet EN 60947-2, 60898-1, IEC 60898-1, IEC 60947-2

- Numri i cikleve mekanike: 20000
- Numri i cikleve elektrike: 10000 cikle
- Temperatura e punës: -35°C deri në 70 °C
- Kategoria e mbitensionit: IV
- Të dhënat kryesore të lëshuesit (kontaktorit) janë:
 - Standardet: EN 60947-4-1, EN 60947-5-1, IEC 60947-4-1, IEC 60947-5-1
 - Tensioni i punës: deri në 690 V
 - Rryma nominale e punës: 25 A
 - Frekuenca: 50 Hz
 - Numri i poleve: 3P
 - Kategoria e mbitensionit: III
 - Tensioni i impulsive: 6 kV
 - Numri i cikleve mekanike: 15 milionë cikle
 - Numri i cikleve elektrike: 1.4 milionë cikle
 - Kontaktet ndimëse: NO + NC
 - Temperatura e lejuar e punës: -40 °C deri në 70 °C
- Të dhënat kryesore të PLC-së janë:
 - Tensioni i ushqimit: 230 V
 - Frekuenca e ushqimit: 50 Hz
 - Pjesët përbërëse: njësia e ushqimit, kontrollori, karta e daljes analoge AC
 - Lloji i PLC-së: kompakte
- Të dhënat kryesore të njësisë së komunikimit dhe dërgimit të të dhënave GSM/GPRS janë:
 - Tensioni i furnizimit: 230 V AC
 - Frekuenca: 50 Hz
 - Komunikimi: GSM/GPRS
 - Porta e komunikimit: RS485

Nw figurwn e mwposhtme jepet skema e komandimit tw pompws zhytwse dhe komandimit nw distancw nga qendra e kontrollit tw qytetit.

Komandimi Automatik & Manual i Pompës Zhytëse duke Përdorur Lëshimin e Drejtëpërdrejtë & Sensor Niveli (Galixhant)




Figura 5.5 Skema e komandimit të pompës zhytëse dhe nivelit të ujit të depos së re nëpërmjet sistemit PLC-SCADA

PUNIMET E TUBACIONEVE

5.12 Të përgjithshme

Punimet e tubacioneve do të përfshijnë transportin, magazinimin, shtrimin, bashkimin, testimin kolaudimin dhe vënien në funksion të tubacioneve dhe elementëve të tjerë përbërës të tyre të cilat do të jenë plotësisht të kompletuara.

Të gjithë elementet duhet të përputhen dhe e gjithë puna duhet të bëhet në përputhje me specifikimet në këtë seksion dhe me seksionet e tjera përkatëse të specifikimeve.

Kostot e të gjithave nyjeve, elementëve të veçantë dhe rakorderive duhet të përfshihen në kostot e njësisë për furnizimin dhe shtrimin e tubave. Asnjë pagesë shtesë nuk do të bëhet për asnjë nyje dhe pajisje.

5.12.1 Tubat PE 100 RC

Tubat duhet të jenë PE 100-RC për ujë të pijshëm dhe në përputhje me DIN 8074/8075, DIN EN 12201 për instalime në kanale pa shtrat rëre, të prodhuar me PE 100-RC me rezistencën më të lartë ndaj plasaritjeve të ngadalta (FNCT kërkesat minimale: ≥ 8760 h në përputhje me PAS 1075; $T=80^{\circ}\text{C}$, $\sigma=4$ N/mm², 2% Arkopal), të verifikuara në përputhje me të dyja DIN 8075 dhe DVGÉ GË 335 A2.

Etiketimi i tubave të bëhen me lazer, duke përfshirë barkodin e gjurmueshmërisë së tipit 128-C, në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt mbi tub.

Tubat duhet të kenë miratime të përditësuara sipas PAS 1075, DVGÉ dhe EN 12201 të cilat Kontraktori do t'ia paraqesë Mbikëqyrësit.

Tubat me diametër deri në 63 mm duhet të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 1, tuba me mure të ngurtë me një shtresë të prodhuar me PE100-RC ose në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat me diametër të barabartë dhe më të madhe se 75 mm do të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat sipas PAS 1075 Type 2, duhet të jenë me një shtresë treguese të integruar me ngjyrë të paktën 10% të trashësisë së murit të tubit në pjesën e jashtme për të lejuar një vlerësim të saktë të sipërfaqes së tubit.

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së materialit sipas PAS 1075 do të kryhet nga testimet, inspektimet dhe certifikimet e miratuara.

Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 50001.

5.12.2 Dorëzimet

Asnjë material i furnizuar sipas këtyre specifikimeve nuk do të dërgohet në vendndodhje pa u miratuar më parë nga Mbikëqyrësi.

Të gjitha dorëzimet do të jenë të kompletuara në të gjitha aspektet duke përfshirë të gjithë informacionin dhe listën e të dhënave këtu dhe të gjithë informacionin shtesë I kërkuar për të vlerësuar përputhshmërinë e materialit të tubave me kontratën.

Të dhënat që do të dorëzohen do të përfshijnë, por jo kufizohen në të dhënat e mëposhtme:

- a) Katalogu i të dhënave që përbëhet nga specifikimet, ilustrimet dhe një program që identifikon materialet që do të përdoren për komponentë dhe aksesore të ndryshëm. Ilustrimet do të jenë të detajuara mjaftueshëm për të ofruar një udhëzues për montimin dhe çmontimin. ;
- b) Vizatimet e bashkimit të rakorderive etj. me dimensione të shënuara qartë. Ky informacion duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar për të shërbyer si një udhëzues për montimin dhe çmontimin dhe për porositjen e pjesëve;
- c) Listimi i të gjithë lubrifikantëve të kërkuar për pajisjet me një minimum prej katër lubrifikantë ekuivalent natyral ose sintetik të prodhuar nga fabrika të ndryshme. Listimi duhet të përfshijë cilësinë e duhur të kërkuar të lubrifikantit, për një vit operim.
- d) Lista e pjesëve rezervë dhe e pajisjeve të montimit (veglave) të veçanta;
- e) Pesha e gjithë pjesëve përbërëse;
- f) Programi i tubave të tabeluar, i cili përfshin informacionin e mëposhtëm për të gjithë tubat dhe rakorderitë: Shërbimi, madhësia e tubit, Presioni I punës, trashësia e murit;
- g) Udhëzimet e prodhuesit për transportimin, shkarkimin, magazinimin dhe instalimin e tubave, rakorderive dhe aksesoreve të tjerë të tubacionit.

5.12.3 Sigurimi i cilësisë

Të gjithë Tubat dhe rakorderitë duhet të prodhohen nga Fabrika të njohura të cilat janë të certifikuara në përputhje me ISO 9001.

Tubat duhet të etiketohen në përputhje me standardet, duke përfshirë: Markën e fabrikës, standardin referencë, materialin e tubit, diametrin dhe presionin nominal.

Të gjithë tubat, veshja e brendshme dhe e jashtme duhet të jenë të çertifikuara për ujë të pijshëm ose përdorim në kanalizime dhe nuk duhet të përmbajnë përbërës që mund të kalojnë në ujë në sasi që konsiderohen toksike ose të dëmshme për shëndetin.

Të gjithë tubat dhe pjesët montuese të zgjedhura në bazë të kësaj kontrate duhet të jenë të cilësisë së parë, formë rrethore të rregullt dhe me trashësi uniforme, pa defekte dhe do të jenë të projektuara për presionin dhe temperaturën e kërkuar.

Kontraktori do të paraqesë certifikatat e prodhuesit dhe certifikatat nga laboratorët e miratuar që vërtetojnë se tubat i janë nënshtruar dhe kanë kaluar me testet e kërkuara sipas standardeve specifike. Të gjithë materialet duhet të jenë në përputhje me standardet e përmendura në këto specifikime.

Të gjithë mallrat duhet të kenë certifikatat e tyre të miratimit para se të përdoren. Kostoja e mostrave, transporti në laborator dhe testimi i tyre përfshihet në çmimin njësi dhe nuk kryhet pagesë shtesë.

Kontraktori duhet të vërtetojë që tubat janë të përshtatshëm për kushtet specifike të instalime në përputhje me standardet Shqiptare ose ekuivalente. Kontraktori do të bëjë llogaritjen për çdo diametër të tubit për të gjitha thellësitë e mundshme (intervali nuk duhet të kalojë 0.5 m), për kushte të ndryshme të dheut dhe për kushte të tjera të ndryshme, të cilat mund të ndryshojnë për shkak të metodave të punës etj.

Asnjë punim nuk do të fillojë pa miratimin e llogaritjeve nga Mbikëqyrësi. Llogaritjet duhet të miratohen nga Mbikëqyrësi përpara porositjes dhe prodhimit të tubave. Kontraktori është plotësisht përgjegjës për llogaritjet e tij.

5.12.4 Piketimi

Para fillimit të gërmimit për ndonjë tubacion do të jetë përgjegjësia e Kontraktorit të piketojë me saktësi aksin e çdo tubacioni në përputhje me vizatimet e miratuara të Kontraktorit. Aksi e tubacionit duhet të shënohet qartë në tokë po ashtu edhe kuotat e tokës aty ku kërkohet nga Mbikëqyrësi.

Rezultatet e rilevimit, që përmbajnë nivelet e tokës, nivelet e koritës në pikat e bashkimit, diametrat dhe detajet e elementeve nëntokësore do të dërgohen Mbikëqyrësit për miratim. Detajet do të konfirmojnë pikat më poshtë:

- Rakorderitë e nevojshme për të bërë lidhjen me tubat ekzistues;
- Aksi dhe kuota e koritës së tubacionit të ri.

Gjithmonë rilevimi i tubacionit do t'i paraprijë gërmimit dhe shtrimit të tubave duke përcaktuar aksin, kuotat dhe pjerrësitë e linjës së tubacionit.

Nëse në opinionin e Kontraktorit, aksi i përcaktuar i tubacionit në bazë të vizatimeve nuk është praktike, Kontraktori mund të propozojë një aks të ri të tubit dhe t'ia dërgojë atë Mbikëqyrësit për miratim. Profili duhet të jetë në përputhje me parametrat e vendosura në vizatime dhe me kërkesat e Mbikëqyrësit.

Mbikëqyrësi duhet që brenda 7 ditëve të kontrollojë dhe të miratojë propozimet e reja të profileve dhe çdo shtyrje e ndërtimit nga vonesa e paraqitjes së propozimeve do të jetë përgjegjësia e Kontraktorit. Asnjë tubacion nuk do të ndërtohet nëse nuk merret paraprakisht miratimi i Mbikëqyrësit.

Gjatë operacioneve të shtrimit të tubave, Kontraktori duhet të sigurojë, rregullojë dhe mirëmbajë në vende e tilla që mund të udhëzohen nga Supervizori, shenime dhe shkopinj nivelues për vendosjen e tubave individualë në shtrirjen e sakte. Shkopinjte duhet të vendosen vertikalisht mbi linjen e tubacionit ose direkt ngjitur me të.

Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha mjetet dhe pajisjet gjatë montimit të tubave përfshirë dhe ato për korrigjimin e aksit. Të gjitha kostot e punimeve të nevojshme për zbatimin e projektit do të mbulohen nga Kontraktori dhe asnjë pagesë shtesë nuk do të kryhet.

5.12.5 Paketimi dhe Transporti

Kontraktori duhet të bëjë aranzhimet e tij për paketimin dhe transportimin e të gjitha pajisjeve dhe materialeve nga prodhuesi në vendndërtim dhe të gjitha kostot, përfshirë pastrimin dhe transportin që duhet të bëhen, duhet të përfshihen në shumën e Kontratës

5.12.6 Transporti

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha angazhimet e tij për paketimin dhe transportimin e të gjitha pajisjeve dhe materialeve nga fabrika prodhuese tek vendi i ndërtimit dhe të gjitha kostot duke përfshirë pastrimin dhe transportimin që do të bëhen, do të përfshihen në vlerën e kontratës.

Transportimi i tubave do të bëhet në përputhje me udhëzimet e fabrikës ku prodhohen tubat.

Gjatë transportit, tubat nuk do të lejohen të qëndrojnë në nyjet e tyre, pjesët e ngushta të automjeteve, ose ndonjë gjë tjetër që mund të rrisë ngarkesat e përqendruara për shkak të peshës së tubit ose goditjes së automjetit por duhet të mbështetet mbi material të butë.

Gjatë transportimit, tubat nuk duhet të kalojnë gjatësinë e automjetit më shumë se 0.6m.

Gjatë transportimit duhet treguar kujdes në këto gjëra:

- Tubat të jenë të pastër dhe pa pluhur;
- Skajet e tubave do të mbulohen me mbulesë të përshtatshme për të parandaluar hyrjen e pluhurit;
- Tubat në shtresat më poshtë nuk duhet të ngarkohen në mënyrë të tillë që të shkaktojë dëme ose shtrembërim të tubave.

5.12.7 Ngarkim-Shkarkimi

Tubat duhet të ngarkohen dhe shkarkohen me kujdesin më të madh në përputhje me rekomandimet e prodhuesit. Kontraktori do të jetë përgjegjës për cilësinë e tubave dhe për gjendjen e tyre para, gjatë dhe pas dërgimit në kantier.

Përpara fillimit të punimeve nga Kontraktori, skajet e tubave, degëzimet e tubave, etj. duhet të izoluar me kapak të përshtatshëm për të parandaluar ndonjë grumbullim të papastërtive ose dëmtim. Kjo mbrojtje duhet të hiqet vetëm në momentin e bashkimit të tubave, rakorderive ose valvulave.

Ngarkim-shkarkimi i pakujdesshëm do të shmanget gjithmonë, sidomos në temperatura të ulëta.

Tubat nuk duhet të hidhen dhe shkarkohen në asnjë mënyrë direkt nga automjeti.

Kontraktori duhet të ketë gjithmonë mbikëqyrje, fuqi punëtore, materiale dhe ambient magazinimi të tilla për të parandaluar në çdo lloj mënyre dëmtimin e tubave.

Duhet të përdoren litarë dhe ganxha të pershtatshme miratuara për ngarkimin dhe shkarkimin e tubave. Nuk duhet të përdoren ganxha të vendosura në sipërfaqen e brendshme në skajet e tubave.

Në asnjë rrethanë tubat nuk duhet të hidhen, lejohen të godasin njeri tjetrin, të rrokullisen lirshëm ose të tërhiqen nëpër tokë.

Nuk do të lejohet asnjë mjet metalik ose objekt i rëndë të bien në kontakt me tubat ose rakorderitë e tubave. Tubat me veshje të jashtme do të ngarkohen ose shkarkohen gjithmonë me rripa të gjerë jo abrazivë, gome, rripa lëkure ose pajisje të tjera të projektuara për të parandaluar dëmtimin e veshjes. Çdo dëmtim i veshjes mbrojtëse të tubave duhet të riparohet përpara testimit të tyre.

Mbikëqyrësi ka të drejtë të anulojë dërgesën e tubave, nëse tubat nuk janë prodhuar siç duhet ose të urdhërojë të testohen pa u montuar, edhe pse nuk ka defekte të dukshme, nëse ka arsye që ngarkimi dhe shkarkimi nuk është bërë siç duhet. Të gjitha kostot e këtyre shërbimeve do të mbulohen nga Kontraktori.

5.12.8 Magazinimi

Të gjithë tubat duhet të magazinohen në përputhje me rekomandimet e prodhuesit, në mënyrë që të ruajnë cilësinë dhe kushtet sipas standardeve të dhëna në Specifikime.

Për magazinimin në kantier, toka duhet të jetë e niveluar dhe e pastër nga gurët.

Gjatë magazinimit dhe transportimit, tubat duhet të kenë sa më afër të jetë e mundur mbështetje të vazhdueshme.

Ngarkesat e tubave nuk duhet të vendosen njeri mbi tjetrin në lartësi më të madhe se 2m.

Një kujdes i veçantë duhet të tregohet për tubat HDPE dhe PVC. Për këta tuba duhet të merren në konsideratë pikat e përgjithshme të mëposhtme:

- Të shmangen kontaktet me cepat e mprehta të metaleve;
- Skajet e tubave duhet të mbrohet nga dëmtimet për të shmangur riskun e bashkimeve jo të sakta;
- Tubat duhet të ruhen dhe të mbrohen nga rrezet direkte të diellit përfshirë edhe magazinimin në vendet e dorëzimit;
- Tubat duhet të ruhen në temperaturë më të ulët se 23°C.

Nëse, për shkak të magazinimit ose ngarkim-shkarkimit është dëmtuar ndonjë tub atëherë pjesa e dëmtuar duhet të pritët komplet me shpenzimet e Kontraktorit.

5.12.9 Instalimi

Instalimi i tubave duhet të bëhet në përputhje me specifikimet e prodhuesit.

Përpara fillimit të punimeve, Kontraktori do të marrë nga prodhuesi të gjitha informacionet e veçanta në lidhje me transportimin e tubave, bashkimin dhe me të gjitha fazat e instalimit të tyre.

Mbikëqyrësi do të kontrollojë tubat në kantier (inspektim vizual i tubave nga brenda dhe jashtë duke përfshirë kontrollet e përmasave) dhe Kontraktori do të shënojë të gjithë tubat e dëmtuar në përputhje me udhëzimet e Mbikëqyrësit dhe duket ti largojë nga kantieri menjëherë dhe ti zëvendësojë ato me tubat e duhur me shpenzimet e tij.

Vetëm tubat e shënuar si të pranuar nga Mbikëqyrësi pas inspektimit në kantier do të lejohen të instalohen.

Përpara montimit, çdo tub dhe rakorderi duhet të kontrollohet brenda dhe jashtë dhe çdo papastërti material i huaj duhet të largohet. Gjithashtu kujdes duhet të tregohet për të mbajtur pastër tubat gjatë shtrimit dhe bashkimeve.

Kontraktori do të kujdeset maksimalisht për të parandaluar çdo dëmtim të tubave, gjatë uljes, shtrirjes dhe bashkimit.

Ne asnjë rrethanë tubat nuk duhet të hidhen në kanal.

Ulja do të realizohet me dorë ose me anë të litarëve dhe mjeteve të përshtatshme.

Kontraktori duhet të sigurohet, që përpara se të vendose tubin, fundi i kanalit të jetë i pastër nga gurët dhe lende të tjera të cilat mund të dëmtojnë veshjen e tubit.

Tuba duhet të vendosen me saktësi sipas planimetrisë dhe kuotave në profilin gjatësor të paraqitura në projekt, brenda një tolerance +/- 5 mm.

Tubat duhet të mbështeten përgjatë gjithë gjatësisë së tij dhe të shtrihen të pa sforcuar.

Kur kanalet kalojnë në rrugë, Kontraktori do të mbrojë tubat nga automjetet pas shtrimit të tyre, gjatë kryerjes së punimeve për riparimin e rrugës. Çdo tub i dëmtuar pas vendosjes së tyre do të zëvendësohet dhe Kontraktori do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet dhe vonesat e shkaktuara.

Një përfaqësues i fabrikës duhet të inspektojë kantierin dhe të demonstrojë procedurat e instalimit në përputhje me udhëzimet e prodhuesit përpara fillimit të montimit.

Kontraktori do të instalojë tubat sipas kuotës së koritës të paraqitur në projekt. Thellësia e vendosjes së tubacionit do të llogaritet si diferenca midis nivelit të tokës natyrale e matur gjatë piketimit minus kuotës së koritës të dhënë në projekt.

5.12.10 Prerja e tubave

Prerja e tubave duhet të jete minimale. Sidoqoftë, duhet të tregohet kujdes për të siguruar që prerje të tilla bëhen vetëm kur është e domosdoshme. Prerja do të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit, pa dëmtim të tubit ose veshjes mbrojtëse dhe në mënyrë që të pjesa ballore të jetë e lëmuar dhe pingul me aksine tubit. Të gjitha prerjet duhet të bëhen me mjete dhe pajisje të duhura për prerje. Në të gjitha rastet, Kontraktori do të jetë përgjegjës për saktësinë e matjes së tubit të prerë të kërkuar. Kontraktori do të përfshijë ne koston e tij çdo shpenzim të bërë për shkak të pjesëve të mbetura.

5.12.11 Sasitë

Para porositjes së tubave, Kontraktori duhet të sigurohet për gjatësinë e nevojshme të secilit lloj tubash, adaptorësh, rakorderi, valvula dhe elemente të veçanta të nevojshme për të përfunduar punimet. Kontraktori nuk do ketë pretendime për sasinë e tepërt ose të mangët të porositur bazuar në Preventiv.

5.12.12 Inspektimi i Punëdhënësit

Punëdhënësi, Mbikëqyrësi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar kanë të drejtë të inspektojnë tubat ose prodhimin e tubave dhe testet e kontrollit të cilësisë. Një inspektim i tillë nuk do të çlirojë në asnjë mënyrë Kontraktorin nga përgjegjësia për të siguruar produkte që përputhen me standardet e zbatueshme brenda këtyre Specifikimeve.

Nëse punëdhënësi zgjedh që të mos inspektojë prodhimin, testimin ose tubat e prodhuar, nuk do të thotë në asnjë mënyrë që ai ta ketë miratuar produktin.

Kostoja e transportit të Punëdhënësit ose Mbikëqyrësit në fabrikë dhe vendet e testimit do të konsiderohet se përfshihet në çmimin njësi (çmimin e Kontratës) dhe nuk paguhen veçmas.

Nëse Mbikëqyrësi konsideron së një segment tubacioni brenda një gjatësie të testuar ka dështuar, Kontraktorit mund t'i kërkohet të testojë hidraulikisht, secilin tub dhe nyje bashkimi para montimit në kantier. Në këtë rast, rezultatet e testeve duhet t'i dorëzohen dhe miratohen nga Mbikëqyrësi përpara se të vendosen tubat e tjerë. Kostoja e testimit të tubave të veçantë do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij.

Punëdhënësi ka të drejtën të punësojë një laborator të pavarur testimi për të kryer teste pranimit. Defektet e zbuluara gjatë këtij inspektimi duhet të korrigjohen me shpenzimet e tij nga Kontraktori. Në rast mosmarrëveshjeje, një laborator i pavarur testimi do të merret si ndërmjetës. Këto shpenzime duhet të paguhen nga pala humbëse.

5.12.13 Rakorderitë

Të gjitha rakorderitë duhet të jenë me të njëjtin material si tubat nëse nuk përcaktohet ndryshe. Rakorderitë duhet të pajisen me një bashkues të përshtatshëm me sistemin e tubacioneve dhe do të sigurohen nga Kontraktori pa ndonjë kosto shtesë. Kostot e të gjitha bashkuesve, pjesëve speciale dhe rakorderive duhet të përfshihen në kostot njësi të tubacionit.

Kontraktori do të furnizojë dhe instalojë komplet tubat dhe pjesët lidhëse të tyre sic kërkohet për ndertimin e linjave të SFU sipas vizatimeve.

Tubat dhe pjesët lidhëse të tyre; saraçineskat dhe pajisjet e tjera të kontrollit të rrjedhjes, do të transportohen, magazinohen dhe montohen/vendosen sipas instruksioneve të dhëna nga Prodhuësi, për të siguruar qëndrueshmërinë e perberësve të tyre dhe për të gjetur garancinë e prodhuesit, të gjitha tubat, pjesët lidhëse dhe aksesoret do të furnizohen vetëm nga një prodhues.

Tubat dhe pjesët lidhëse do të transportohen në terren në një magazinë të ndërmjetme, pa ngarkesë, do të instalohen në kanal të tubave në linjë të drejtë, në thellësinë dhe pjerresinë e treguar në Vizatime dhe të ngjitur duke përfshirë të gjitha punët e nevojshme shtesë sipas instruksioneve të prodhuesit.

Prodhuësi i tubave do të sigurojë llogaritjet strukturore.

Tubat dhe pjesët lidhëse do të kenë kontroll cilësie sipas EN, DIN apo të ngjashme dhe shenjat e prodhuesit.

Kujdes duhet të tregohet për sigurimin e kushteve të shtratit të tubave sipas specifikimeve të dhëna. I gjithë tubi duhet të vendoset në pozicion dhe të instalohet drejt sipas profilit dhe drejtimit të pjerresisë të dhënë në seksionin gjatësor mbi shkallën e kerkuar. Përpara se tubat të jenë bashkuar ato do të pastrohen nga të gjitha llumrat, guret apo objekte të tjera që mund të kenë hyrë brenda tyre.

Ne fund te cdo dite pune dhe kur puna eshte nderprere per nje periudhe kohore, fundet e lira te tubave te shtruar duhet te mbrohen nga mbulesa te pershtatshme kundrejt hyrjes se pislleqeve apo materialeve te tjera te huaja.

Kur shtrimi i tubave nuk eshte ne progres, fundet e hapura te tubave te instaluar do te mbyllen per te mos lejuar hyrjen e ujit te kanalit ne linje. Gjithmone uji duhet te perjashtohet nga futja ne brendesi te tubave dhe mbushja do te jete e tille qe te mbroje tubat nga pluskimi. Ne se ndonje tub do te pluskoje, ai do te hiqet nga kanali dhe do te vendoset sipas direktivave te dhena nga Inxhinieri. Asnje tub nuk do te vendoset ne kushte te lageshtise se kanalit qe nuk lejon vendosjen e shtratit ne menyren e duhur ose kur per opinionin e Inxhinierit, kushtet e kanalit apo te motit jane te papershtatshme per instalimin korrekt te tyre.

Tubat do te vendosen me pjerresine e dhene ne Vizatime.

5.12.14 Vizatimet

Perpara ngritjes se strukturave metalike, vizatimet duhet te paraqiten tek Inxhinieri per aprovim. Riprodhimi i vizatimeve te kontrates si vizatime aktuale jane te papranueshme.

a. Sigurimi i tipit, grada, dimensionet dhe detaje te tjera te trareve dhe rrjeteve te ndertuara duke perfshire perforcimet, aksesoret dhe ankorimet. Diagramat e hekurit, te asamblimit, te bashkimit dhe vendosjes se shufrave dhe kendeve. Dimensionet jo ne shkalle nga vizatimet e strukturave do te percaktojne gjatesine e shufrave te perforcimit.

Aprovimi i nje produkti do jepet nga Inxhinieri ne kantier vetem pas prezantimit te nje shembulli te pranueshem te cdo tipi.

5.12.15 Vendi i Origjinës së Materialeve

Kontraktori do të jetë specifik për vendin e origjinës dhe firmën prodhuese të materialeve që do të furnizojë në bazë të Kontratës, dhe do t'i dërgojë të gjithë katalogët përkatës Mbikëqyrësit. Para konfirmimit të importit të çdo materiali, Kontraktori duhet të marrë miratimin me shkrim të Mbikëqyrësit.

5.12.16 Bashkuesit me elektrofuzion

Bashkuesit me elektrofuzion të tubave PE 100-RC duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Materiali: PE 100
- Klasa e presionit: SDR 11
- I përshtatshëm për instalim në kanale pa shtrat rëre
- të dy anët mund të saldohen (ngjiten) njëkohësisht
- me ndalim qendror
- thellësia e futjes në përputhje me kërkesat maksimale të ISO
- Zona të gjata të ftohta
- kompensimi i temperaturës (koha e ngjitjes rregullohet automatikisht sipas temperaturës së ambientit)
- me barkod për procesin automatik të saldimit.
- me barkod gjurmueshmërie.

Skajet e tubit do të përgatiten sipas udhëzimeve të instalimit të prodhuesit.

Bashkuesit duhet të kenë certifikime të përditësuara sipas DVGÜ and EN 12201.

Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 50001.

5.12.17 Testimi i tubave në fabrikë

- Kontraktori duhet të ketë kryer testet e mëposhtme dhe të paraqesë certifikata të përditësuara të testimeve të lëshuar nga një organ i akredituar për testimet:
- Testet e miratimit të materialit në përputhje me PAS 1031 dhe PAS 1075 Table 1 a dhe 1 b,
- Testet e sigurimit të cilësisë së materialit në përputhje me PAS 1075 Table 2,
- Testet e miratimit të tubit në përputhje me PAS 1075 Table 3,
- Testet e kontrollit të cilësisë së tubit në përputhje me PAS 1075 Table 4.

5.12.18 Testet pas dorëzimit

• Mostrat e tubave HDPE merren në mënyrë të rastësishme ose siç udhëzohet nga Mbikëqyrësi. Mbikëqyrësi mund të kryejë, përveç testeve të Cilësisë dhe Pranimit, cilindro ose të gjitha testet e mëposhtme në mostrat e marra:

- Testimet për rezistencën në rrjedhshmëri, zgjatimin relativ në rrjedhshmëri si dhe rezistencën dhe zgjatimin relativ në këputje sipas standardit shqiptar ose ekuivalent ISO 527,
- Testi për gërvishtjen e shtresës mbrojtëse të jashtme

5.12.19 Shtirirja e tubave PE

Tubat dhe rakorderitë duhet të bashkohen me saldimit me elektro-fuzion mbi tokë dhe do të mbështeten mbi mbështetëse të lëmuar të miratuar më parë nga Mbikëqyrësi. Çdo tub në secilën anë të makinës salduese do të kenë minimum dy mbështetës. Të gjitha nyjet e bashkimit duhet të inspektohen pas saldimit dhe të regjistrohen nga makineria e saldimit.

Të gjitha nyjet do të miratohen nga Mbikëqyrësi përpara se Kontraktori të vazhdojë me punimet e shtrimit të tubave. Gjatësia maksimale e tërheqjes së tubave PE të bashkuar në pozicionin përgjatë kanalit ose direkt në kanal nuk duhet të kalojë 300 m ose sa gjatësia e maksimale që lejohet nga pajisja hidraulike e makinës së elektro-fuzionit. Tërheqja direkt në sipërfaqen e tokës është rreptësisht e ndaluar. Të gjithë bashkimet e rakorderive, degëzimeve, etj. të cilat montohen (saldohen) në kanal duhet të bëhen nga manikota me saldimit automatik me elektro-fuzion ose rakorderi të tjera të cilat bashkohen elektro-fuzionit.

Fundi i kanalit duhet të jetë i pastër nga gurët ose pjesë të forta të cilat mund të dëmtojnë tubin. Përpara se tubacioni ose elementë të tij të ulet në kanal, nyjet e bashkimit duhet të jenë ftohur mjaftueshëm. Gjatë uljes së tubit në kanal duhet të ketë kujdes të veçantë në vendet e takimit të tubit me pjesët anash dhe në fund. Kujdes i veçantë duhet të tregohet gjatë kryqëzimeve me strukturat ose rrjetet e tjera. Mbështetëset rrethore të tubave për 4 gjatësitë fillestare të tubave nga fundi i tubit i cili duhet të ulet në kanal duhet të sigurohet.

Ndryshimet graduale në planimetri dhe profil mund të bëhen nga deformimi i lehtë i tubit në të ftohtë, por në asnjë rast tubi nuk duhet të kthehet në një rreze më të vogël se 25 herë diametri i jashtëm i tubit. Në asnjë rrethanë nuk do të lejohet kthimi i tubit në të nxehtë në kantier. Tubi duhet të mbahet sa më shumë të jetë e mundur në qendër të kanalit për të siguruar ngjeshjen e duhur të mbushjes anësore, por do të lejohen disa lakime të vogla për të kompensuar bymimin linear të tubit nga ndryshimi i temperaturës.

5.12.20 Bashkimi i tubave PE

Të gjithë tubat PE dhe rakorderitë të tyre do të bashkohen me pajisje automatike elektrike me elektro-fuzion. Të gjitha pajisjet automatike të saldimit me elektro-fuzion duhet të kenë mundësinë e

regjistrimit dhe printimit të të dhënave të saldimit. Kontraktori duhet të sigurojë një pajisje për transferimin e të dhënave nga pajisja e elektrofuzyonit në kompjuter.

Kompleti i plotë i pajisjes të saldimit automatik me elektrofuzyon do të përfshijë si më poshtë:

- Kutia e Kontrollit automatik të pajisjes e aftë të funksionojë në një mënyrë plotësisht automatike, për tubacione deri në diametrin nominal të jashtëm, të përdorur në Projekt. Do të ketë mundësinë e transferimit të të dhënave për të gjitha nyjet e saldimit.
- Gjenerator i lëvizshëm i përshtatshëm për të furnizuar me energji pajisjen e elektrofuzyonit.
- Morseta të përgjithshme me unaza për tubat, shume funksionale për manikotat, bërrylat dhe degëzimet T.

Procedura për saldimet me elektrofuzyon do të jete si vijon:

- Drejtohen skajet e tubave dhe hiqet ndonjë pjesë e mbetur. Kontrollohen tubat dhe rakorderitë e tyre për futjen e duhur në manikotat. Nëse tubat kanë formë ovale të theksuar dhe nuk futen në manikotat bashkuese, tubat duhet të riformësohen në formë më rrethore nga një pajisje të miratur për këtë qëllim.
- Fundet e tubit të pastrohen me një kruarese universale ose një pajisje të aprovuar për përgatitjen e sipërfaqes të afte të heqë sipërfaqen e oksiduar së fundeve të tubave për një thellësi me të madhe se thellësia e depertimit. Për instalimin e tapave tek T dhe mbështetjeve sipërfaqja e përgjithshme a bazes së mbështetës pastrohen përtej përtej sipërfaqes së bashkimit deri kur Supervizori të japë aprovimin e tij. Pajisja duhet të zhvendose një shtresë me trashësi 0.2 – 0.4mm nga sipërfaqja e jashtme mundësisht me shtresë të vazhduara në të gjithë gjatësinë e aplikimit në tub ose në të gjithë sipërfaqen e bazes së mbështetës. Gërryerësit e dorës të tipit Harris ose ekuivalent janë të lejuar për taposjen e T dhe mbështetësve.
- Sipërfaqja e përgatitur duhet pastrohet me acetone ose tretësira të tjera të aprovuara. Sipërfaqja e tubit të përgatitur nuk duhet përdoret ose ndotuar përpara saldimit.
- Manikotat elektrofuzyon ose taposjes së T duhet të hiqen nga paketimi dhe pastruar nga gratatime me acetone ose tretësira të tjera të aprovuara përpara montimeve apo bashkimeve në tubacion. Thellësia e futjes është markuar atëherë me një shënues të përshtatshëm nëpërmjet futjes në manikotat apo bashkues deri kur ato nuk mund të futen më.
- Përdor madhësi të sakta të kapesve të tubit dhe manikotave, siguro aksesoret e tubave. Akset dhe hapësirat ndërmjet mureve të tubit dhe manikotave duhet të kontrollohen nëpërmjet pajisjeve për matjen e thellësisë. Hapësirat totale ndërmjet diametrit të jashtëm të tubit dhe manikotës nuk duhet të kalojë 2% të diametrit nominal të jashtëm të tubit. Manikotat dhe aksesoret e tjera bashkues duhet të rregullohen në anet e tyre në mënyrë të përshtatshme, nëse kërkohet, për t'u instaluar në një aks si tubi ashtu edhe manikotat apo aksesoret bashkues.

Procesi i ngjitjes me elektrofuzyon duhet të lejohet të vazhdojë vetëm pasi të plotësohen kushtet e mësipërme.

- Në përfundim, treguesit e shkrirjes të bashkuesve tek buzet duhet të dallohen. Nëse nuk ka levizje të dukshme të treguesve të shkrirjes, bashkimi duhet të pritë dhe një bashkim I ri duhet të realizohet.
- Bashkimi duhet të lihet në kapese për kohën e specifikuar të ftohjes të manikotës ose aksesorit bashkues.

Tubacionet kryesore nuk duhet të mbyllen me prerës të integruar deri kur bashkimet ose mbeshtetëset të jenë aprovuar nga Supervizori.

5.12.21 Shpëlarja

Perpara marrjes në operim, Kontraktori do të bëjë një shpëlarje të linjave të ujit të pijshëm duke përfshirë dhe largimin e depozitimeve.

5.12.22 Disinfektimi i tubave

Të gjithë tubat do të disinfektohen përpara se të vihen në shërbim sipas urdherit të Inxhinierit. Disinfektimi do të kryhet nga përdorimi i klorines. Perpara dizinfektimit, linjat e tubave do të shpëlahen me ujë të pastër në një shpejtesë prej afro 1 m në sekonde. Klorinimi i tubave do të ketë efekt nga futja e një solucionit klorine në një koncentrim prej afro 25 mg/l në tuba kështu që një mbetje klorine prej jo më pak se 10mg/l mbetet në ujë pas 24 orësh të mbylljes së tubave. Presioni i disinfektimit nuk do të ndikojë në cilësinë e ujit të puseve. Solucioni i klorines do të gjendet nga një perzierje e ujit dhe një klorine të njohur si hipoklorit kalciumi ose gelqere e klorinuar e quajtur "bleaching powder" ose hipoklorit sodium i lenget (i njohur si "liquid laundry bleach"). Pas disinfektimit të tubave do të bëhet shpëlarja e tyre me ujë të pastër derisa uji të bëhet i pijshëm. Uji i përdorur për disinfektim nuk do të përdoret për qëllime të furnizimit me ujë.

Cmimi për disinfektimin do të llogaritet në një cmim për meter të linjave që janë disinfektuar. Të gjitha kostot direkte dhe indirekte do të përfshihen në cmim.

5.13 Tubat dhe pjesët prej gize.

Tubat e gizes për sistemin e furnizimit me ujë do të kenë karakteristikat dhe kërkesat sipas EN 545/10 dhe specifikimeve bashkëngjitur projektit.

- Tuba gize për ujë të pijshëm në përputhje me standardet EN 545: 2010, ISO 2531: 2009, tuba të klasës C40, C30 dhe C25;
- nga DN80 deri DN600: gjatësi tubi 6 metra;
- nga DN700 deri DN1000: gjatësi tubi 7 metra;
- mbi DN1100: gjatësi tubi 8 metra.

Tubat zakonisht do të kenë në një folë për lidhje elastike, me anë të një unazë gome në përputhje me UNI 9163/87, me unazë elastomeri sipas standardit EN 681-1. Nga ana tjetër, nëse autorizohet, mund të përdoret lidhje elastik e tipit Tyton, sipas DIN 28603.

Sistem ankerimi për DN1100 ose më të madh, tubacionet duhet të jenë të pajisur me një sistem fiksimi me anë të një tegel saldimit. Funkcionet hidraulike dhe të fiksimit duhet të jenë të ndara.

Lidhja duhet të lejojë zhvendosjen këndore dhe devijimet gjatësore të tubit pa kompromentuar lidhjen.

Tubat, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga kërkesat e projektimit, duhet të jenë të veshura nga brenda me llaç çimentoje sipas EN 545/10 (shënuar me CE në bazë të Rregullores Evropiane 305/2011) dhe ISO 4179, dhe nga jashtë me një shtresë aliazi zinku dhe alumini ose Zn-Al aliaz bakri Cu, monofazor (Zn 80-90%; 10-20% Al), 400 gr/m², aplikuar si veshje dhe veshje reshire sintetike në përputhje me trashësi të zinkut jo më pak se 70 pM (UNI ISO 8179).

5.13.1 Të përgjithshme

Të gjithë materialet duhet të jenë në përputhje me standardet EN, ISO ose ndonjë standard tjetër ekuivalent, do të furnizohen nga prodhues të certifikuar për tubacionet e ujit të pijshëm deri në 50 °C. Të gjitha punimet e tubave do të jenë të klasës K9.

5.13.1.1 Standardet dhe kodet e aplikueshme

Kodet dhe standardet të zbatueshme për punimet sipas këtij kapitulli janë rënditur më poshtë.

- ISO 2531:2009: Tubat, rekorderitë, aksesorët dhe bashkuesit e tyre prej gize duktile për ujë ose gaz
- EN 545:2010: Tubat, rekorderitë, aksesorët dhe bashkuesit e tyre prej gize duktile për tubacionet e ujit. Kërkesat dhe metodat e testimeve.
- ISO 4179:2005: Tubat dhe rekorderitë prej gize duktile për tubacionet me dhe pa presion – Veshja e brendshme me llac çimentoje.
- ISO 8179-1:2004: Tubat prej gize duktile – Veshja e jashtme me bazë Zinku. Pjesa 1 – Shtresa prej metalit të zinkut.
- të gjitha testimet e presionit dhe operimit, sipas udhëzimeve të prodhuesit sipas Vizatimeve Standarde dhe Specifikimeve të Përgjithshme Teknike.

Cmimi përfshin vënien në punë të valvulës për uljen e presionit sipas specifikimeve të prodhuesit.

5.14.13 Valvula për ruajtjen e presionit

- Valvula për ruajtjen e presionit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
- Me mbështetje elastike dhe guarnicion i butë
- Kontrollonhet nga prurja

- Kontroll pilot për të mbajtur presion konstant nga rrjedha e sipërme
- Përbëhet nga valvula kryesore boshti i kontrollit dhe valvula pilot
- Niveli i presionit në rrjedhën e sipërme: 1 - 20 bar
- Të gjitha pjesët e brendshme të arritshme nga lart pa hequr tubin
- Me tregues te pozicionit dhe 2 manometra
- Trup të drejtë
- Materiali i trupit: gize
- Diafragma: NBR ose EPDM
- Materiali izolues: EPDM
- Boshti i kontrollit dhe vidat lidhëse prej çeliku të pandryshkshëm;
- Të jetë llogaritur kundër kavitetit
- Presioni nominal: PN 16
- Fllanxhat sipas EN 1092-2
- Dimensionet sipas EN 558, Seria 1
- Testimet për presionin dhe funksionimin ndaj EN 12266 dhe EN 1074
- Mbrojtja nga korrozioni i pjesëve të trupit: Veshja e brendshme dhe e jashtme me epoksi ngjyrë blu "mbrojtje nga korrozioni për industrinë e rëndë" sipas DIN 30 677-2, trashësia e shtresës: të paktën 250 µm
- E certifikuar për ujë të pijshëm
- Të gjitha pjesët e lagura duhet të plotësojnë kërkesat sipas DVGË (bazat e testit DVGË GË337), KTË Ë270, ËRAS, ose ACS.

5.14.14 Valvulat e kontrollit të prurjes

Valvulat sferike të kontrollit sipas EN 1074-5 do të ketë një trup prej gize duktile (GGG-50), duhet të jetë me model të drejtë, të pajisur me një piston, bosht dhe një cilindër të fiksuar prej çeliku të pandryshkshëm, i pajisur me timon dore.

Pistoni i kontrollit i udhëzuar nga unaza rrëshqitëse prej PTFE ose NBR i cili lëviz brenda këtij cilindri që mbyll ose hap valvulat sipas pozicionit të kontrollit të kërkuar.

Valvulat e kontrollit të prurjes duhet të jetë e pajisur me një tregues mekanik të pozicionit.

Valvula e kontrollit të prurjes duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Presioni nominal: PN 16
- Fllanxhat sipas EN 1092-2
- Testimet për presionin dhe funksionimin ndaj EN 12266 dhe EN 1074
- Mbrojtja nga korrozioni i pjesëve të trupit: Veshja e brendshme dhe e jashtme me epoksi ngjyrë blu "mbrojtje nga korrozioni për industrinë e rëndë" sipas DIN 30 677-2, trashësia e shtresës: të paktën 250 µm
- E certifikuar për ujë të pijshëm
- Të gjitha pjesët e lagura duhet të plotësojnë kërkesat sipas DVGË (bazat e testit DVGË GË337), KTË Ë270, ËRAS, ose ACS.

5.14.15 Nyja për montim-çmontimin (kompensator montimi)

Nyja për montim-çmontimin duhet të jetë e certifikuar për ujë të pijshëm dhe përbëhet nga tre fllanxha sipas standardit ISO 7005. Trupi duhet të bëhet nga çeliku, brenda dhe jashtë veshur me epoksi. Përfshirë: bulona, dado, rondele dhe guarnicione.

5.14.16 Filtrat

Filtrat duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Filtri do të jetë tipi "Y" i bërë nga giza duktile, sita prej çeliku të pandryshkshëm, fllanxhat me vrima sipas EN1092-2. Përfshirë bulonat prej çeliku të galvanizuar, dadot, rondelet dhe guarnicionet të aprovuara për ujë të pijshëm.

5.14.17 Përshtatësit (adaptorët) me fllanxha për tubacione me materiale të ndryshme

Përshtatësit me fllanxha do të jetë me tolerancë të madhe, për mundësi lidhje të llojeve të ndryshme të tubave prej gize duktile, me guarnicion gome EPDM dhe mbrojtjen anti-korozive epoxy.

Përshtatësi me fllanxhë fllanxhës me fole për tuba PE / PVC.

Përfshirë: bulonat prej çeliku, Dado, rondelat dhe guarnicionet.

5.15 Hidrantët

Hidrantët përfshijnë të gjitha materialet, punën, mjetet dhe pajisjet e nevojshme për furnizimin dhe instalimin e elementeve të hidrantëve.


Hidranti duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Hidrant zjarri mbi sipërfaqen e tokës DN 80 sipas EN 1074-6
- Me manikotë B
- Fllanxhat sipas EN 1092-2, PN10
- Me drenazhim automatik
- I rrotullueshëm
- I certifikuar për ujë të pijshëm sipas DVGË (baza e testimit DVGË GË337), KTË Ë270, ËRAS, ose ACS
- Materiali: gize duktile
- Mbrojtja nga korrozioni: Pjesa e sipërme (Upper barrel) dhe kapaku: Veshje epoksi, nga jashtë veshje shtesë me poliestër

Elementet plotësues të furnizimit dhe vendosjes së hidrantit sic janë të dhëna në vizatimet perkatese.



Hidrant mbi toke, PN 16, DN80 2C 1B



Berryl 90°, gize për lidhje me fllanxha, Tipi N sipas EN 545, DN 100




Tub bashkimi me fllanxhe dyshe DN 100, PN10/16, gjatesia 220mm



Përshtatësi

Fllanxhe, PE tipi i gjatë DN 110 për bashkim me elektrofuzion, PN16



Fllanxhe PP e zeze me perforcuese celiku SDR11 DN 110, PN16



Valvul tipi thike, Gize, DN 100, me fllanxha DN 110mm, PN16

Standardet:

- I projektuar sipas EN 1074 – 6:2008 dhe EN 14384:2005
- Standardi i hapjes se vrimave te fllanxhës EN1092-2 (ISO 7005-2), PN16

Testet qe duhet te garantoj:

- Testi hidraulik sipas EN 1074-6 / VP 325 (3321)
- Testi hidraulik sipas EN 1074-1 dhe 2 / EN 12266
- Aprovimi sipas CE Reg. No. 0620-CPR-6122

5.16 Mates prurjesh**5.16.1 Matesa familjare**

Matesat familjare do te jene me trup metalik dhe duhet te projektohen ne perputhje me klimen e Europes. Matesat duhet te kene nje dizenjim modular, me nje kuti te jashtme dhe nje hapësire e brendshme per matje te vecante. Dhoma e matjes duhet te jete e levizshme ne menyre qe te nderrohet me lehtësi pa patur nevojë qe te cmontohet trupi i matesit.

Regjistrimi i prurjes do te behet me lexim te drejtperdrejte ne metra kub, me shigjeta te vecanta qe tregojne matjet ne te vlerat me te uleta. Shigjetat duhet te levizin ne drejtimin e akrepave te ores.

Per nje rregullim te lehte dhe te sakte te kalibrimit, shifrat duhet te rregjistrojne aq sa per te lejuar lexim te sakte te 0.5% te vlimit nominal qe kalon. Te gjithë matesat e ujit duhet te jene te pajisur me nje kapak i cili duhet te jete i mbuluar dhe te mbuloje dhe pjesen e kutise se regjistrimit ne menyre qe te mbroje lentet. Te gjithë matesat e ujit duhet te pajisen me tel dhe vula prej plumbi per qellimin e vulosjes se matesave.

Te gjitha pjeset qe jane ne kontakt me ujin duhet te kene siperfaqe te lemuara te mbrojtura ne menyre qe te evitojne depozitimet e mikrobeve. Matesat e ujit duhet te projektohen per nje jetegjatesi prej 10 vjetesh ne kushte normale funksionimi. Te gjitha matesat e ujit duhet te jene te miratuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Metereologjise te Shqiperise ose nga persona juridike te cilet jane autorizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Metereologjise te Shqiperise sipas miratimit te MID (Direktiva e Bashkimit European per pajisjet matese) dhe ligjit Nr. 9875 me date 14.02.2008 perpara se te instalohen.

Matesat e ujit familjar, DN½" deri ne DN 2" duhet te permbushin kerkesat dhe kushtet qe vijojne:

Kerkesa Teknike:

- Pjesa e bronzte e matesit te ujit duhet te jete ne perputhje me direktivat e ujit te pijshem 98/83/EC dhe 98/83/EG, norma origjinale e vertetuar nga Certifikata.
- Matesit e ujit DN 1" dhe DN 2" duhet te pershtaten per lexim ne distance (pulsimi duhet te korrespondoje me nje sasi prej 0,1 m³).

Shenime

Ne cdo mates uji duhet te jene te shenuara ne siperfaqen e jashtme ose ne xhamin e ekranit informacionet si me poshte:

- Te pakten nje shigjete ne per te treguar drejtimin e rrjedhjes
- Masa nominale
- Shkalla nominale e rrjedhes (Q)
- Identifikimi i modelit
- Viti i prodhimit
- Numri serial

- Numri i miratimit
- Emri i Prodhuesit

Ne rast se nuk tregohet ndryshe, duhet të shenohet të trupi i matesit ose të gdhendet mbi kapak ose të jete e shenuar në pjesën e brendshme ose përndryshe të shenohet në një vend të përshtatshëm.

Paketimi

Cdo mates uji duhet të pakëtohet në një kuti prej letre të vëzuar me dy fije. Cdo kuti leter e vëzuar do të përmbajë sikurse tipi i matesit të ujit, vlerat e Qn, gjatësinë, temperaturën dhe presionin. Kutitë e matesave duhet të montohen në paletë dhe të ruhen nga shiu dhe lagështia.

Garancia e Fabrikes

Furnizuesi duhet të sigurojë një garanci prej 3 vitesh për cdo defekt të prodhimit. Cdo mates që nuk punon gjatë periudhës së garancisë do të zëvendësohet ose të riparohet pa asnjë pagesë. Furnizuesi duhet të sigurojë një garanci prej 15 vitesh për të gjitha pjesët e këmbimit të matesave. Për më tepër, në fillim të cdo viti, furnizuesi duhet të japë Punedhësit një listë cmimesh për vitin respektiv. Furnizimi dhe dorëzimi i matesave të ujit me fushe të thatë (tipi multi-jet dry type dial) do të përdoret si mates për shtëpitë që kanë mundësi për tu integruar në Sistemin-AMR, të përgatitur për lexim në distancë.

Standarte:

Matesat duhet të jenë në përputhje me standartin EN14154 (përkatesisht ISO 4064), OIML R 49 botuar në 2006 E. Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001:2008 seria ose sipas një certifikimi ekuivalent. Të gjithë matesat e ujit duhet të kenë miratimin MID ose deklaratën e përshtatjes dhe Prodhimi dhe Materiali duhet të jenë prodhuara në vendet e EU-së.

Kërkesat teknike:

- Xham special me mundësi për montimin direkt pa kabell të pajisjes së leximit – preferoren pa shumë fileto.
- Pajisja e leximit me shifrat që rrotullohen and minimumi 3 ose 4 shifra të jenë të lexueshme pasi të montohet pajisja e leximit në distancë.
- Të dhëna Dinamike Metrologjike (Q3/Q1) R 80 (Klasa B) për Q 2.5 dhe 4.0m³/h (të jenë të vërtetuara me certifikate)
- Montime horizontale dhe vertikale, kërkohet pozicioni!
- Shifrat treguese: 5-numra, 4 shigjeta, 1 tregues i rrjedhjes
- Kutitë të jenë prej bronxi të presuar për një performancë sa më të mirë hidraulike, në përputhje me direktivat për ujë dhe pijshëm 98/83/EC dhe me rregulloren 98/83/EG; vida rregulluese për kalibrim në pjesën e sipërme të kutisë së brendshme
- Kapaku mbrojtës prej plastike speciale
- Valvul mos këthimi: të jenë të instaluar në pjesën e brendshme dhe pa prishur vulën
- Filtri i instaluar në hyrje, duhet të hiqet me lehtësi pa çmontuar matesin dhe pa prishur vulën

5.16.2 Mates elektromagnetik

Matesi elektromagnetik i prurjeve të Ujit do të jetë:

- Mates elektromagnetik, Split version
- Presioni i Operimit: PN 10
- Qmax = 200 ÷ 220 m³/h
- Siguria e matjes ± 0.15 % i vlerës së matur

- Dalja e pare analoge 0 - 21 mA.
- Opsion i Programueshem per celes te nje shkalle matje automatike
- Opsion për dalje analoge te dytë
- Dalje pulsesh per matje te dyfishte, perpara dhe kthim pas nga 0 - 800 Hz.
- Celes Transistor per anoncim te dopio alarm
- Celesa me perdorim te Programuar dhe nje RS 232
- Elektroda matje dhe tokezimi me celik inoksi
- Linja tubi matese EPDM, te pershtatshme per uje t epijshem
- Ekran LCD me tastier

Vetmonitorues, diagnostifikues i gabimeve, program matjesh, rezultate matjesh (shkalla e prurjes, volume total, etj)

- 2 dalje pulsesh dhe 2 alarme
- Dalje 1 mA
- Sensor Matje te mbrojtur sipas IP 68
- Kabell lidhes ndermjet sensorit te matjeve, L=30 m
- Bateri me AC dhe back up
- Operimi i baterise: Dy bateri 3.6 V (Lithium), 2.5 vit jetegjatesi

5.17 Shpimi i pusit

Diametri i shpimit të pusit bazohet në kriteret e mëposhtme:

- Pusi do të shkarkojë një sasi prej "Q max" [m³/h] siç specifikohet në Parashikimin e Sasisë.
- Pusi duhet të shpohet në një thellësi minimale të specifikuar si "Thellësia e shpimit" [m] në vizatime dhe/ose në paragraf. Për arsye sigurie, pajisjet e Kontraktorit duhet të jenë në gjendje të arrijnë të paktën në thellësi 80 m.
- Diametrat e brendshëm të tubit të mbështjellësit dhe të tubit të ekranit duhet të jenë siç specifikohet "Kllëfi i identifikimit" dhe "Ekranit ID" [mm] në vizatime dhe/ose në preventive.
- Pusi duhet të shpohet në diametrin minimal të specifikuar si "Diametri i shpimit" [mm] në vizatime dhe/ose në paragraf. Hapësira unazore ndërmjet tubit të mbështjelljes/trupit dhe diametrin të shpimit duhet të mbushet me zhavorr filtri me një min. gjeresie 4" (100 mm). përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në vizatime dhe/ose në preventiv (diametri minimal i shpimit = diametri i tubit të jashtëm të këllëfit / ekranit + 200 mm ... përveç nëse specifikohet ndryshe).
- Në pjesën fundore të sipërme të pusit, do të instalohet një tub i mbështjellësit të përcjellësit, i specifikuar si "Diametri i mbështjellësit të përcjellësit" [mm] dhe "Gjatësia e mbështjellësit të përcjellësit" [m] në vizatimet dhe/ose në paragrafin e sasive. Hapësira unazore ndërmjet tubit të mbështjellësit të përcjellësit dhe tubit të shtresës së pusit duhet të mbyllet me argjilë zgjeruese (grumbulla bentoniti ose të ngjashme).
- Nuk do të lejohen shpime me bentonit. Puset do të shpohen (ose përplasen) të mbyllura. Mbulesa duhet të hiqet në pjesë pas mbushjes së hapësirës unazore me zhavorr filtri. Seksionet e zbrazëta në majë të pusit duhet të mbushen me argjilë zgjeruese (grumbulla bentoniti ose të ngjashme).
- Marrja e plotë e mostrave të prerjeve duhet të kryhet sipas udhëzimeve DVGĚ/Ě114 si parakusht dhe duhet pasur kujdes që të mos humbasin fraksionet e imta nga larja e pakujdesshme e mostrës. Personeli i kontraktorit do të marrë udhëzimet përkatëse nga mbikëqyrja e shpimit. Mostrat do të merren në intervale 1 m dhe në çdo ndryshim të materialit formues. Mostrat duhet

të ruhen në qese plastike transparente. Emri i projektit, numrat e pusit, intervalet e thellësisë, emri i kontraktorit dhe data do të shënohen në thasë. Shkrimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj ujit. Përdorimi i shënuesve me majë të ndjerë ("Edding") nuk lejohet. Mostrat nga çdo vrimë e shpimit do të ruhen në kuti të ngurta mostrash me kapak. Emri i projektit, pusi nr°, thellësia (nga ...m në ...m), emri dhe data e kontraktorit do të shënohen në kapakë dhe në pjesën e përparme të kutive të mostrës.

- Nëse rendimenti është 20 % më i ulët se prodhimi i pritur (krahasuar me kërkesat e kontratës dhe/ose rendimentin e puseve të tjera), Inxhinieri mund të kërkojë rishpimin e pusit me koston e Kontraktorit.
- Nëse, sipas mendimit të Inxhinierit (Inxhinierit Mbikëqyrës), pusi ka prodhim të pamjaftueshëm që nuk është shkaktuar nga aktivitetet e gabuara të shpimit, paketimit të zhavorrit ose zhvillimit, mbikëqyrja e shpimit mund të udhëzojë kontraktorin të shpojë një të ri. mirë në një vend të rënë dakord. Kontraktori do të paguhet me tarifat e njësisë të përcaktuara në preventiv, me përjashtim të instalimit shtesë në terren dhe lëvizjes së pajisjeve.

Tubat e kokës së pusit duhet të jenë prej tubash çeliku (S235JR (St37-2)) në përputhje me EN 10224 (DIN2460), të galvanizuar në nxehtësi për mbrojtje nga korrozioni në përputhje me EN 10240, lidhje me fillanxa sipas DIN 4922-3 të shpuara sipas EN 1092, me diametër dhe përmasa të përcaktuara në vizatimet dhe faturën e sasive. Çmimi për kokën e pusit do të përfshijë lidhësit e nevojshëm në kabinën e pusit dhe tubat e përcjellësit.

- Koka e pusit duhet të përmbajë:
- Lidhje tubash për tubin e mbështjellësit dhe tubin e përcjellësit
- Kanalet kabllore me kasë për kabllot e energjisë dhe sinjalit të pompës zhytëse dhe sensorëve të nivelit të ujit
- Lidhja e tubit për tubin e vëzhgimit të nivelit të ujit
- Ventilimi

5.17.1 Filter zhavori

E gjithë gjatësia e hapësirës unazore ndërmjet vrimës së shpimit dhe këllëfit/filtrit duhet të mbushet me zhavorr filtri silikat të larë mirë të rrumbullakosura në përputhje me DIN E-4924. Madhësitë e kokrave të zhavorrit të filtrit ndoshta do të variojnë midis madhësive të specifikuara në vizatime dhe/ose në faturën e sasive. Sasia e zhavorrit të filtrit të përdorur duhet të krahasohet me vlerën teorike. Për këtë qëllim do të mbahen shënime për çdo pus. Zhavorri duhet të mbushet me kujdes dhe ngadalë për të shmangur tejkalimin. Gjatë procesit të zhavorrit, një pistoni duhet të lëvizet ngadalë lart e poshtë për disa metra përballë nivelit aktual të majës së zhavorrit për të shmangur urën dhe për të ngjeshur zhavorrin.

5.17.2 Zhvillimi i pusit

Menjehere pas punimeve të zhavorrit, pusi do të zhvillohet. Zhvillimi i pusit konsiston në aktivitetet e mëposhtme:

- Pompimi për të hequr trupat e imet dhe turbullira derisa uji të pastrohet.
- Zhvillimi sipas seksionit nga lëvizjet lart-poshtë të një vegje të tipit me paketim të dyfishtë që lejon veprimet e pompimit dhe ngritjes, ose nga lëvizjet sipas seksionit të një vegje ngritëse ajri që lejojnë ngritje dhe pompim. Operacionet e ngritjes së ajrit do të kërkojnë një kompresor me

kapacitet të lartë. Nëse Kontraktori synon të operojë me pajisje ngritëse me ajër, ai duhet të paraqesë një përshkrim të detajuar të mjeteve dhe procedurës. Ngritja e thjeshtë e ajrit duke fryrë ajrin e ngjeshur në pus nëpërmjet një tubi ajri nuk do të lejohet.

- Zhvillimi do të vazhdojë derisa uji të jetë i pastër dhe përmbajtja e ngurtë të qëndrojë nën një kufi prej 8 mg/l rërë, baltë, argjilë. Kjo përmbajtje do të verifikohet me anë të një koni Imhoff që kontraktori duhet të sigurojë.

5.17.3 Testet e pompimit

Menjëherë pas pastrimit dhe zhvillimit të puseve do të kryhen provat e pompimit. Kontraktori do të sigurojë pajisje të përshtatshme për ekzekutimin, duke përfshirë tubat e shkarkimit, matësat e ujit dhe rakorderite. Materiali i furnizuar për instalim të përhershëm mund të përdoret për provë.

Testet e pompimit do të përbëhen nga fazat e mëposhtme:

1. Test shkarkimi i perbere nga 4 shkalle me kohëzgjatje prej 3 orësh secila, i ndjekur nga matjet e rikuperimit. Shkarkimet do të jenë përafërsisht. 25% - 50% - 75% - 100% e kapacitetit maksimal të pusit "Q max" siç specifikohet në Preventiv.
2. Një test shkarkimi konstant me kohëzgjatje 24 orë me rendimentin maksimal të lejuar të përcaktuar nga testi i shkarkimit në shkallë, i ndjekur nga matjet e rikuperimit. Kohëzgjatja e provës së pompës mund të ndryshohet nga inxhinieri mbikëqyrës.
3. Gjatë provës, ulja e nivelit të ujit në puset dhe piezometrat ngjitur duhet të matet dhe të regjistrohet, paralelisht me uljen e nivelit të ujit në pusin e testuar.

Kontraktori duhet të sigurojë një regjistruar të nivelit të ujit, të sondes që përshtatet në tubin e vëzhgimit të nivelit të ujit dhe të pakten 2 mates elektrik të nivelit të ujit. Shkarkimet do të maten me mates uji. Kontraktori do të përshkruajë llojin (et) e pajisjeve matëse që ai synon të përdorë.

5.17.4 Analiza e cilësisë së ujit

Pas përfundimit të testit të pompimit, cilësia e ujit të pusit (eve) do të analizohet. Procedura e marrjes së mostrave duhet të jetë në përputhje me standardet kombëtare.

5.17.5 Analiza bakterologjike

Analiza bakterologjike duhet të bëhet sipas Standardit Kombëtar dhe të mbulojë së paku: Numrin total të baktereve, numrin e baktereve koliform dhe numrin e baktereve Escherichia Coli.

5.18 Kalimet me HDD

5.18.1 Te përgjithshme

Ky raport detajon metodat me të cilat kontraktori synon të kryejë punët e propozuara në kontratë.

Shpimi me drejtim horizontal (HDD) është një teknikë për instalimin e tubave të produktit, duke përfshirë linjat e shërbimeve, nën tokë duke përdorur një pajisje shpimi të montuar në sipërfaqe që lëshon dhe vendos një varg shpimi në një kënd të cekët me sipërfaqen dhe ka aftësi gjurmuese dhe drejtuese.

5.18.2 Pajisjet

Pajisja mund të prodhojë tunele që variojnë në madhësi nga 50 mm në 500 mm me gjatësi tipike të drejtimit nga 120 m deri në 360 m në varësi të kushteve të tokës, pajisjeve të përdorura dhe thellësisë së shpimit. I gjithë procesi i shpimit kontrollon nga një operator nga paneli qendror i kontrollit të njësisë së

furnizimit me energji elektrike së bashku me një operator tjetër në vend, i cili drejton në distancë kokën e shpimit me ndihmën e një marrësi të specializuar. Njësia pneumatike e shpimit horizontal (raketë) funksionon me parimin e goditjes së dyfishtë. Komplet i mjeteve të mërztishme ka dy ingranazhe dhe frekuenca goditjesh dhe përdoret për shpime horizontale nën rrugë, rrugë dhe kanale.



Figura 0-1: Paraqitja ne plan e kalimit me HDD

Kontraktori është përgjegjës për të siguruar zbatimin e procedurës së ndërtimit dhe deklaratës së metodës, mbikëqyrjen e punës dhe raportimin e përparimit të punës tek Supervizori.

Inxhinieri i kantjerit është përgjegjës për prezantimin, informimin dhe këshillimin e të gjithë personelit dhe vizitorëve të kantjerit.

Inxhinieri është përgjegjës për monitorimin e ekzekutimit dhe kryerjes së punimeve në lidhje me këtë deklaratë të metodës, vizatimet e miratuara dhe specifikimet teknike. Ai duhet të njoftojë supervizorin për inspektim. Inxhinieri i kantjerit është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet të kryhen në mënyrë të sigurt në kantier, duke vendosur planin e sigurisë së vendit, duke kryer inspektimin e vazhdueshëm të sigurisë dhe për të ndaluar çdo punë të pasigurt.

5.18.3 Mbrojtja e linjave ekzistuese.

Kontraktori do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shërbimeve ekzistuese, të cilat do të ndodhen në zonën e Punimeve. Kur një shërbim (linje) ekzistues ndërhyr në punime, Kontraktori do të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim dhe do të organizojë me ta veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren (d.m.th. mbrojtja, largimi, zhvendosja, etj.). Çdo udhëzim i dhënë nga këto shërbime do të ndiqet.

5.18.4 Qasja dhe ballafaqimi me trafikun.

Gjatë zbatimit të punimeve, Kontraktori do të bashkëpunojë dhe koordinojë me Autoritetet Rrugore dhe të Policisë të gjitha ndërhyrjet në rrugët publike. Kontraktori do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar hyrjen dhe daljen e automjeteve nga kantieri që të depozitohen baltë ose mbeturina të tjera në sipërfaqen e rrugëve ose shtigjeve ngjitur, dhe do të heqë me shpejtësi çdo material të depozituar në këtë mënyrë.

Menaxhimi i trafikut do të ndjekë procedurat e mëposhtme.

Me bisedime informative, Kontraktori do të informojë banorët e zonës për punimet që do të kryhen, përpara se t'i nisë ato në zonën përkatëse.

Si Përgjegjësi ashtu edhe inxhinieret e kantjerit lejohen të informojnë dhe të bisedojnë me njerëzit, të cilët do të jenë të interesuar të dinë rreth punimeve. Do të vendoset një tabelë për të informuar njerëzit për punimet që po kryhen.

Kontraktori do të vendosë sinjale për ndalim parkimi në pjesën e sipërme të rrugës, në të cilën do të kryhen punimet.




Figura 0-2: Sinjalistika

Njerëzit do të informohen me gojë për punimet që do të kryhen, duke kërkuar që të mos parkojnë në zonën e sipërme.

Në rast nevojë do të përfshihet edhe policia rrugore për të detyruar largimin e mjeteve nga rruga e punimeve.

Kontraktori duhet të rrethojë punimet me rrethim të pershtatshe paralajmerues, të instaluar në distance sigurie nga zona e operimit. Rrethimi do të vendoset ndërmjet shtyllave të çelikut, të fiksuara në bazamente të parapërgatitura prej betoni.



Figura 0-3: Rrethimi

Në anë të rrugës, zona e punës do të mbrohet duke vendosur sinjalizime dhe shtylla betoni (duke mbrojtur punetoret ashtu edhe publikun e gjerë).

6 PUNIMET E BETONIT

6.1 Të përgjithshme

6.1.1 Referencat

- EN 206-1: 2013: Betoni. Specifikimet, performanca, prodhimi dhe përputhshmëria.
- BS 8500-1:2015+A1:2016 Betoni. Standardet Britanike plotësuese të EN 206. Metoda e specifikimit dhe udhëzimi për specifikuesin.
- BS 8500-2:2015+A1:2016 Betoni. Standardet Britanike plotësuese të EN 206. Specifikimet për materialet përbërëse dhe betonin.
- EN 1990: Eurokodi 2002-Bazat e projektimit struktural.
- EN 13813: 2002 Shtresat dhe materialet niveluese – Vetitë dhe kërkesat.
- CEN. Përdorimi i konceptit të familjeve të betonit për prodhimin dhe kontrollin e përputhshmërisë të betonit. Raporti 13901
- EN 12350 Testimi i betonit të njomë.
- EN 12390 Testimi i betonit të ngurtësuar.
- EN 12504 Testimi i betonit në ndërtesa.
- EN 197-1: Çimento – Pjesa e parë: Përbërja, specifikimet dhe kriteret e përputhshmërisë për çimentot e zakonshëm.
- EN 12620 Agregatet për betonin
- EN 13055 Agregatet me peshë të lehtë
- EN 932-3 Provat për vetitë e përgjithshme të agregateve - Pjesa 3: Procedurat dhe terminologjia për përshkrimin e thjeshtë petrografik
- EN 934-2: 2001 Receptura për betonin, llaçin dhe çimento – Pjesa 2: Receptura për betonin – Përkufizime, kërkesa, përputhshmëria, shënimi dhe etiketimi.
- ISO 1920-2: Testimi i betonit – Pjesa 2: Veçoritë e betonit të freskët.

6.1.2 Materialet përbërëse

Betoni do të përbëhet nga çimento, agregate të granuluara dhe uji, të përziera plotësisht, të vendosur dhe të ngjeshur sipas specifikimeve që jepen në paragrafët e mëposhtëm. Vlerat e rekomanduara, për përzierjen dhe vetitë e betonit jepen në tabelën e mëposhtme në varësi të klasave të ekspozimit.




Figura 6-1: Klasat e ekspozimit ambiental

Tabela 6-1: Vlerat e rekomanduara kufitare të përbërseve dhe vetitë e betonit (Tabela F.1 – EN 206)

Kërkesa	Klasat e ekspozimit																
	Pa rrezik ndryshkije të armaturës	Ndryshkije e shkaktuar nga veprimi i karbonit				Ndryshkije e shkaktuar nga veprimi i klorit				Ekspozimi ndaj cikleve ngrirje – shkrije				Ambiente me agresivitet kimik			
		veprimi i karbonit				klorure përveç ujit të detit				shkrije				agresivitet kimik			
		XC1	XC2	XC3	XC4	XS1	XS2	XS3	XD1	XD2	XD3	XF1	XF2	XF3	XF4	XA1	XA2
Raporti Max U/C	0.65	0.60	0.55	0.50	0.50	0.45	0.45	0.55	0.55	0.45	0.55	0.55	0.50	0.54	0.55	0.50	0.45
Klasa minimale C	20/25	25/30	30/37	30/37	30/37	35/45	35/45	30/37	30/37	35/45	30/37	25/30	30/37	30/37	30/37	30/37	35/45
Përmbajtja minimale e çimentos ^c (kg/m ³)	260	280	280	300	300	320	340	300	300	320	300	300	320	340	300	320	360
Përmbajtja minimale e ajrit (%)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4.0 ^a	4.0 ^a	4.0 ^a	-	-	-
Kërkesa të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Agregati në përputhje me EN 12620 me rezistencë të mjaftueshme ndaj cikleve ngrirje - shkrije				Çimento rezistente ndaj sulfateve	

- Në rastin kur betoni nuk ka përmbajtje ajri, performanca e betonit do të testohet në përputhje me një test të përshtatshëm në duke e krahasuar me një beton për të cilin është vlerësuar më parë rezistenca ndaj cikleve ngrirje – shkrije.
- Në rast se sulfatet e gjendura në mjedis, çojnë në klasën e ekspozimit XA2 dhe/ose XA3, është thelbësore përdorimi i çimentove anti – sulfate në përputhje me EN 197-1 ose standardet vendase përkatëse.
- Aty ku aplikohet koncepti i vlerës "k", vlera maksimale e raportit U/C dhe vlera minimale e përmbajtjes së çimentos do të modifikohet në përputhje me paragrafin 5.1.12

6.1.3 Çimento

Çimentoja dhe materialet prej çimentoje duhet të jenë në përputhje me EN 206-1.

Tabela 6-2: 27 Produktet e familjes së zakonshme të çimentos (Tabela 1 – EN 197 – 1)

Tipi	Emërtimi (në varësi të shtesës)	Simboli	Përbërja (përqindje e masës)		
			Klinker	% e shtesës	% shtesa të tjera më të vogla
CEM I	Çimento Portland	CEM I	95 – 100	-	0 – 5
CEM II	Çimento Portland me Skorie	CEM II / A-S	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-S	65 – 79	21 – 35	0 – 5
	Çimento Portland me Mikrosilicë	CEM II / A-D	90 – 94	6 – 10	0 – 5
	Çimento Portland me Shtesa Pucalanike	CEM II / A-P	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-P	65 – 79	21 – 35	0 – 5
		CEM II / A-Q	90 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-Q	65 – 79	21 – 35	0 – 5
	Çimento Portland me Shtesa Hiri Teci	CEM II / A-V	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-V	65 – 79	21 – 35	0 – 5
		CEM II / A-Ë	90 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-Ë	65 – 79	21 – 35	0 – 5
	Çimento Portland me Shtesa Shiste Gëlqërore	CEM II / A-T	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-T	65 – 79	21 – 35	0 – 5
	Çimento Portland me Shtesa Gëlqërore	CEM II / A-L	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-L	65 – 79	21 – 35	0 – 5
		CEM II / A-LL	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-LL	65 – 79	21 – 35	0 – 5
	Çimento Portland e Përzier	CEM II / A-M	80 – 94	6 – 20	0 – 5
		CEM II / B-M	65 – 79	21 – 35	0 – 5
	CEM III	Çimento me Skorie të Furrëllartave	CEM III / A	35 – 64	36 – 65
CEM III / B			20 – 34	66 – 80	0 – 5
CEM III / C			5 – 19	81 – 95	0 – 5
CEM IV	Çimento Portland Pozzolane	CEM IV / A	65 – 89	11 – 35	0 – 5
		CEM IV / B	45 – 64	36 – 55	0 – 5
CEM V	Çimento Portland e Përzier	CEM V / A	40 – 64	18 – 30	0 – 5
		CEM V / B	20 – 38	31 – 50	0 – 5

Kur kërkohet çimento rezistente ndaj sulfateve, çimentoja e përzgjedhur duhet të jetë e përshtatshme sipas klasës kimike të dhënë në projekt.

Kur specifikohet ose kur është e përshtatshme për t'u përdorur, Çimento Portland CEM II, III, IV apo V, duhet të përputhen me proporcionet e përzierjes të specifikuar në EN 206-1 dhe EN 197.

Materialit i çimentos duhet të kenë një përmbajtje të alkalisht reaktiv që nuk kalon vlerën prej 0.6% të masës dhe/ose masa totale e alkalisht reaktiv në miks duhet të llogaritet dhe kontrollohet për të përmbushur kërkesat e EN 206-1.

Kontraktori duhet të njoftojë sa më parë Mbikëqyrësin në lidhje me fabrikën ku mendon të furnizohet me çimento si dhe për mënyrën sesi do të furnizohet me çimento. Porositë e blerjes së çimentos duhet të përmbajnë kërkesat e cilësisë dhe procedurat e kontrollit të cilësisë të cilat duhet të miratohen

nga Mbikëqyrësi po keshtu dhe certifikatat e testimit në fabrikës duhet të dorëzohen bashkë me çdo dërgesë.

Kontraktori duhet të marrë certifikatat e testeve specifike për çdo dërgesë çimentoje nga furnizuesi dhe duhet t'ia dorëzojë Mbikëqyrësit për miratim.

Çimentoja duhet të jetë e freskët kur të arrije në kantier dhe Kontraktori duhet ta përdorë sipas radhës së dërgesës. Kontraktori duhet të shënojë datën e marrjes së secilës dërgesë dhe secila dërgesë duhet të ruhet veçmas nga tjetra.

Çimentoja duhet të ruhet në ambiente kundër lagështisë dhe me një temperaturë jo më të ulët se 8°C dhe ti vendosë thasët e çimentos në paleta mbi sipërfaqen e dyshemesë.

Kontraktori nuk duhet të përdorë çimento që është ngurtësuar, por duhet të largojë pjesët e ngurtësuar nëpërmjet sitimit të çimentos dhe Mbikëqyrësi mund të lejojë përdorimin e kësaj çimentoje në përzierje betoni jo struktural. Çimentoja e depozituar në kantier për më tepër se 4 muaj nuk do të përdoret përveç rasteve kur provohet se plotëson kërkesat e cilësisë.

Çimento që do të përdoret për prodhimin e betonit do të mbartë vulën origjinale të "Conformité Européene" - CE.

6.1.4 Agregatet e betonit

Të gjitha agregatet e betonit duhet të merren nga burime të aprovuara nga Mbikëqyrësi. Duhet të merren mostra të agregateve të trashë dhe të imët dhe testet specifike do të realizohen para se të behet porosia në lidhje me cilësinë ose llojin, ose siç udhëzohet nga Mbikëqyrësi për të konfirmuar përshtatshmërinë e tyre për betonin. Agregatet nuk duhet të përmbajnë elementë të dëmshëm pasi mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë e betonit ose të shkaktojnë korrozionin e armaturës.

6.1.4.1 Përmasat e grimcave të agregateve

Përmasa maksimale nominale e agregateve nuk duhet të kalojë 30 mm, duke siguruar që përmasa maksimale e agregateve të jetë si më poshtë:

- 1/4 e dimensionit më të vogël të një elementit struktural;
- 5 mm më pak se distanca ndërmjet shufrave të armaturës, përveç rasteve kur janë marrë masa të veçanta, si p.sh. grupimi i shufrave të armimit;
- Sa 1/3 herë trashësia e elementit të betonit.

Agregatet për përdorim në beton duhet të përmbushintë gjitha kërkesat e standartit EN 12620:2002+A1:2008 - "Agregatet për betonin"; dhe veç kësaj kriteret specifike në vazhdim do të aplikohen kur të testohet në përputhje me EN 932: 2007 "Testet për vetitë e përgjithshëm të agregateve. Metodat e marrjes së mostrave".

Agregatet nuk duhet të përmbajnë asnjë material të dëmshëm reaktiv me bazat alkale në çimento, ose asnjë përbërje bazike e cila mund të jetë prezentë në agregate dhe në ujin e përzierjes në sasi të mjaftueshme për të shkaktuar zgjerimin e tepërt të betonit ose të llaçit. Nëse analiza e agregateve ASTM C 289 "Metoda Standarde e testimit të reaktivitetit të agregateve (metoda kimike)" ose ASTM C 295 "Praktika standarde e rekomanduar për ekzaminimin petrografik (studimi i përmbajtjes mineralogjike të shkëmbinjve) të agregateve për betonin", tregojnë që një shkëmb reagon në mënyrë të dëmshme, atëherë agregatet që përmbajnë këto elementë nuk do të lejohen të përdoren në punët e përhershme.

6.1.4.2 Agregatet e trashë

Agregati i trashë i përdorur në beton ose për ndonjë qëllim tjetër duhet të jetë ose zhavorr ose gur i copëzuar në përmasat e duhura.

Zhavorri natyral do të jetë i pastër nga dheu, argjila, shtresa vegjetale, argjilitet, shistet, ose gurët e dekompozuar, materialet organike dhe nga papastërtitë e tjera dhe duhet të jetë i dendur dhe i fortë. Gurët me përmasa më të mëdha ose më të vogla jashtë diapazonit të përmasave të kërkuara do të ndalohen në sita dhe nuk do të përdoren në punët e përhershme.

Gurët e thyer duhet të jenë të fortë dhe të qëndrueshëm. Pavarësisht nga miratimi i Mbikëqyrësit për burimin e tij, gurët pasi janë dërguar në terren do të jenë subjekt i refuzimit nëse për ndonjë arsye mbikëqyrësi do t'i konsiderojë të papranueshëm.

Duhet të jenë shumë të pastër dhe pa argjila të buta, shiste apo gurë të copëtuar. Gurët do të copëtohen në një makineri të thyerjes së gurit të tipit të miratuar me përmasat e kërkuara dhe pluhurat apo materialet e imëta nën 5 mm duhet të hiqen nëpërmjet sitimit dhe të mos përdoren në punë të përhershme.

Gradimi i agregateve të trasha me analizë do të jetë brenda limiteve të dhëna në EN 12620:2002+A1:2008. Nëse një analizë e përmasave të grimcave të materialit tregon mungesë në një përmasë të veçantë të tillë që të ndikojë densitetin e betonit, Mbikëqyrësi do t'i kërkojë kontraktorit të shtojë një sasi të tillë agregati të një përmasë të veçantë që ai mund ta konsiderojë të këshillueshme. Në çdo rast materiali kur përzihet me agregate të holla do të prodhojë një përzierje të graduar mirë nga përmasa më e madhe te ajo më e vogla e specifikuar për të siguruar një beton me densitet të lartë.

Agregatet e trashë duhet të testohen për karakteristikat ndaj tkurrjes nga tharja në përputhje me EN 1367-4. Tkurrja nga tharja nuk duhet të kalojë 0.075%. Niveli i SO₃ nuk duhet të kalojë vlerat e specifikuara në EN 12620. Përmbajtja totale e llogaritur e SO₃ duhet të jetë në përputhje me kufijtë e dhëna në EN 206-1. Karakteristikat e fortësisë dhe gërryerjes së agregatit duhet të jenë në përputhje me EN 12620. Niveli maksimal i lejuar i joneve CL⁻ për çdo përbërës ose kombinimi i përbërësve të betonit e forcuar nuk duhet të kalojë kufijtë e dhëna në EN 206-1.

Provat duhet të kryhen në përputhje me standardet përkatëse EN 932, EN 933, EN 1097 dhe EN 1744.

Sasia e substancave shuarëse nuk do të kalojë kufijtë e mëposhtëm në përqindje ndaj peshës.

Tabela 6-3: Kufizimet në përmbajtjen e substancave shuarese në beton

Argjilë e mbetur në sitë 20 mm	0.40
Argjilë në total	0.70
Oksid i kuq i butë	0.25
Qymyr	0.25
Pjesëza shkëmbi të buta ose të shpërbëra	2.50
Grafit	0.25
Totali si më sipër mbetur në site 20 mm	1.00
Totali i mësipërm	1.50
Përqëndrime toptash argjile	0.25
Pjesë të holla ose te stërzgjatura me një gjatësi më të madhe se 5 herë trashësia mes	15.00
Material që kalon sitën nr. 200	0.50

Tabela 6-4: Agregati i trashë për beton, kërkesat e madhësisë

Madhësia e sitës (mm)	Madhësia maksimale nominale e agregatit			
	Përqindjet sipas peshës			
	40mm	20mm	16mm	10mm
50	10			
40	95-100	100		
25				
20	50-95	95-100	100	
16			95-100	
13				100
10	20-40	35-65	45-30	85-100
6	<5		<30	10-30
2.36		<10		<10

6.1.4.3 Agregati i imët

Agregati i imët që përdoret për betonin, laçet dhe çimentot, duhet të jetë rërë e pastër dhe duhet të jetë larë tërësisht para përdorimit.

Rëra për përdorim në llaçin e çimentos, çimentimin dhe finon duhet të jetë në përputhje me EN 13139:2002 "Agregatet për llaçin".

Agregatet e imët do të pranohen në përputhje me kërkesat e mëposhtme. Agregatet e imët do të konsistojnë në pjesëza shkëmbi të fortë e të durueshëm, përveç se kur agregatet e imët e të trashë prodhohen njëkohësisht dhe nga të njëjtat operacione prej depozitave natyrore të zhavorrit, agregati i imët mund të përmbajë pjesëza shkëmbi të copëtuar të një natyre e cilësie të njëjtë me atë që prodhohen nga operacioni normal i copëtimit dhe veçimit të materialeve mbi madhësinë e caktuar. Ai duhet të jetë kimikisht inert, i fortë ose me porozitet të kufizuar dhe të mos përmbajë argjile ose qymyr apo papastërti të tjera që mund të shkaktojnë korrozionin e armaturës ose mund të dëmtojnë fortësinë ose durueshmërinë e betonit. Sasia e substancave shuese nuk do të kalojë kufijtë e mëposhtëm në përqindje ndaj peshës:

Qymyr e linjit	0.25
Material që kalon sitën nr. 200	2.00
Substanca të tjera (si argjilë, alkale mike, grimca të veshura, pesëza të buta, të vetme ose të kombinuara)	2.50

Tabela 6-5: Agregati i imët për beton, kërkesat e madhësisë

Sita (mm)	Përqindja (sipas peshës)
10	100
6	95-100
2.36	75-100
1.18	55-100
0.6	30-60
0.3	5-30
0.15	<10

6.1.5 Uji

Uji për betoni duhet të jetë në përputhje me EN 1008:2002.

Uji për beton nuk duhet të përmbajë përbërës të dëmshëm në sasi të tilla që të jenë shkatërrues për mpiksjen, ngurtësimin dhe qëndrueshmërinë e betonit ose të shkaktojnë korrozionin e armaturës. Në përgjithësi uji i pijshëm i marrë nga furnizimi lokal publik është i përshtatshëm për përgatitjen e betonit.

Kontraktori duhet të marrë masat personale që të sigurojë një furnizim të mjaftueshëm të ujit të miratuar për prodhimin dhe mbrojtjen e betonit.

Në përgjithësi, uji për qëllime ndërtimi duhet të përputhet me këto standarde:

Për të bërë përzierjen e betonit dhe llaçin, uji duhet të jetë i freskët, pa sedimente, apo materiale të shpërbërë apo të ndërprerë të cilët mund të jenë të dëmshëm për prodhimin e betonit të specifikuar. Mbikëqyrësi mund t'i kërkojë kontraktorit t'i dorëzojë mostra të ujit nga burimet e furnizimit me ujë të menduara dhe t'i analizoje në një laborator të miratuar përpara se ndonjë punim betoni të ketë nisur dhe në intervale gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Nëse në ndonjë moment, mostrat provohen të jenë të pakënaqshme, Kontraktori duhet të ndryshojë burimin ose të marrë masa, të pranueshme për Mbikëqyrësin, duke hequr masën e cënuar me shpenzimet e tij. Kontraktori duhet të deklarojë burimin apo burimet nga ku ai propozon të marri ujin dhe të paraqesë prova që është siguruar një burim i përshtatshëm.

Për trajtimin e betonit është i pranueshëm vetëm ujë i freskët dhe i pastër.

6.1.6 Struktura e betonit

Betoni duhet të përgatitet i tillë që pas tkurrjes të ketë një strukturë të mbyllur, p.sh. kur të ngjishet në një mënyrë standarde, vëllimi i përmbajtjes së ajrit nuk do të jetë më shumë se 3% për përmasën nominale të agregatit $\geq 16\text{mm}$ dhe 4% për përmasën nominale të agregatit $< 16\text{mm}$, pa përfshirë ajrin dhe poret e agregatit.

6.1.7 Përmbajtja e klorureve në beton

Sasia e joneve të klorit të betonit nuk duhet ta kalojë vlerën e vendosur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6-6: Përmbajtja e klorit në beton

Betoni	Cl – si përqindje e masës së çimentos
Beton	1%
Beton i armuar	0,4%
Beton i paranderur	0,2%

Kloruri i kalciumit dhe përzierjet me bazë klori nuk do të shtohen në betonin e armuar, betonin e paranderur dhe strukturat kompozite, përveç rasteve kur përdorimi i tyre është i lejuar nga standarde kombëtare dhe rregulla të vlefshme në vendin e punës.

6.1.8 Konsistenca gjatë derdhjes në vend

Niveli i konsistencës duhet të jetë i tillë që betoni i sapo bërë të jetë i punueshëm pa filluar të segregohet dhe i tillë që mund të ngjeshet plotësisht në kushtet e terrenit.

Që të sigurohet një ngjeshje e përshtatshme e betonit të derdhur në vend rekomandohet që konsistenca e betonit në kohën e derdhjes duhet të përputhet me klasën e konsistencës S3 ose me klasën e rrjedhjes F3 përveç rasteve kur janë marrë masa të tjera.

Tabela 6-7: Klasat e vetive të betonit të freskët

Klasat e konsistencës	
Klasa	Konsistenca e testuar në përputhje me EN 12350-2 (mm)
S1	10 – 40
S2	50 – 90
S3	100 – 150
S4	160 – 210
S5 ^a	≥220
Klasat e rrjedhjes	
Klasa	Diametri i rrjedhjes i testuar në përputhje me EN 12350-5 (mm)
F1 ^a	≤340
F2	350 – 410
F3	420 – 480
F4	490 – 550
F5	560 – 620
F6 ^a	≥ 630
Klasat e ngjeshjes	
Klasa	Shkalla e ngjeshjes e testuar sipas EN 12350 – 4
C0 ^a	≥ 1,46
C1	1,45 deri në 1,26
C2	1,25 deri në 1,11
C3	1,10 deri në 1,04
C4 ^b	< 1,04
Klasat e shpërndarjes (slump floë)	
Klasa	Shpërndarja^c e testuar sipas EN 12350 – 8 (mm)
SF1	550 – 650
SF2	660 – 750
SF3	760 – 850
<p>a. Nëse do të kërkohet përcaktimi i konsistencës, do të bëhet nëpërmjet njërit nga testet e përshkruar në EN 12350</p> <p>b. Klasa C4 aplikohet vetëm për betonet e lehtë</p> <p>c. Ky klasifikim nuk aplikohet për betone me D_{max} që kalon 40mm</p>	

6.1.9 Rezistenca ndaj reaksioneve të silicit në mjedis bazik

Disa agregate mund të përmbajnë varietete të veçanta të silicit të prekshëm ndaj sulmeve të agjentëve bazik (Na_2O dhe K_2O) me origjinë nga çimento ose burime të tjera. Pastaj në prezencë të lagështisë, ndodh një reaksion zgjerimi, i cili mund të rezultojë në plasaritje ose në çarje të betonit. Në kushte të tilla mbikëqyrësi mund të kërkojë një ose disa nga të mëposhtmet:

- Kufizimin i përmbajtjes së tretësirave bazike në përzierjen e betonit.
- Përdorimi i çimentos me përmbajtje të ulët të bazave efektive.
- Ndryshimi i agregateve.
- Kufizimin e shkallës së ngopjes së betonit, p.sh: me membrana të papërshkueshme.

6.1.10 Temperatura e betonit

Përveç rasteve kur janë marrë masa të veçanta, temperatura e betonit të sapo bërë nuk duhet të kalojë 30°C dhe nuk duhet të jetë nën 5°C në kohën midis përzierjes dhe derdhjes (për trajtimin e temperaturës shiko rregullat e veçantë në paragrafin 6.2.3.8)

Mjedisi në këtë kontekst ka të bëjë me ato veprime kimike dhe fizike ndaj të cilave betoni është i ekspozuar dhe që rezultojnë në efekte që nuk janë konsideruar si ngarkesa në projektin struktural.

6.1.11 Vetitë e betonit dhe metodat e verifikimit

Konsistenca e betonit duhet te përcaktohet me anë të metoda të përshkruara në EN 12350 ku përfshihen: testi i konsistencës, testi Vebe, testi i ngjeshjes dhe testi i rrjedhjes; ose me metoda alternative të dakorduara.

6.1.11.1 Përmbajtja e ajrit

Përmbajtja e ajrit të betonit të sapo përgatitur do të përcaktohet në përputhje me EN 12350-7 për betonet normale dhe të rëndë dhe ASTM C 173 për betonet e lehtë. Për betonet e ekspozuar ndaj cikleve ngrirje shkrirje dhe me klasë ekspozimi XF2, XF3 dhe XF4, përmbajtja e ajrit do të jetë minimalisht 4% (Referoju Tabelës 5.1 të këtyre specifikimeve ose Tabela F.1 – EN 206).

Tabela e mëposhtme e bazuar në buletin inxhinierik 001 të "Portland Cement Association – PCA" – Projektimi dhe Kontrolli i Përzierjeve të Betonit – Edicioni 14, jep vlera referencë të përmbajtjes së ajrit në beton në varësi të përmasës maksimale të agregatit.

Tabela 6-8: Rekomandime për vlerat totale të synuara të përmbajtjes së ajrit në beton

Përmasa maksimale nominale e agregatit (mm)	Përmbajtja e ajrit, në përqindje (%)*		
	Ekspozim i ashpër ^a	Ekspozim i moderuar ^b	Ekspozim i lehtë ^c
<9.5	9	7	5
9.5	7.5	6	4.5
12.5	7	5.5	4
19	6	5	3.5
25	6	4.5	3
37.5	4.5	4.5	2.5
50**	5	4	2
75**	4.5	3.5	1.5

*Specifikimet e projektit, mund të lejojnë një përmbajtje të ajrit në beton të variojnë midis vlerave -1 deri në +2 % të atyre të treguara në tabelë.

**Këto përmbajtje të ajrit vlejné për përzierjen totale, si për përmasat e mëparshme të agregateve. Gjithsesi, gjatë testimit të këtyre betoneve, agregatet më të mëdha se 37.5mm largohen me dorë ose nëpërmjet sitimit dhe përmbajtja e ajrit përcaktohet si të ishte beton me agregate 37.5mm duke marrë parasysh tolerancat me minus apo plus siç shpjegohen më sipër.

- Betone të ekspozuara ndaj cikleve ngrirje – shkrirje, agjentët shkrirës ose agjentë agresivë.
- Betone të ekspozuara ndaj ngrirjes por jo vazhdimisht të lagur dhe nuk kanë kontakt me agjentë shkrirës apo kimikate agresive.
- Betone të pa ekspozuara ndaj kushteve të ngrirjes, agjentëve shkrirës apo kimikate agresive.

6.1.11.2 Zhvillimi i rezistencës

Zhvillimi i rezistencës duhet të përcaktohet nga testet e rezistencës në ngjeshje për moshat e paracaktuara të betonit. Mostrat për përcaktimin e rezistencës në ngjeshje do të merren, të pregatiten, të trajtohen dhe testohen në përputhje me kërkesat e EN 12350-1, EN 12390-1, EN 12390-2 dhe EN 12390-3.

Për përcaktimin e kohës së trajtimit, informacioni mbi zhvillimin e rezistencës së betonit jepet në termat e shprehura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6-9: Zhvillimi i rezistencës së betonit në temperaturë 20°C (Tab 16 - EN 206)

Zhvillimi i rezistencës	Raporti i rezistencës: $r = \frac{f_{cm,2}}{f_{cm,28}}$
E shpejtë	≥ 0.5
Mesatare	$0.3 \leq r < 0.5$
E ngadaltë	$0.15 \leq r < 0.3$
Shumë e ngaltë	< 0.15

6.1.11.3 Rezistenca ndaj depërtimit të ujit

Betoni duhet të ketë një koeficient të penetrimit K më pak ose të barabartë me 1×10^{-11} m/s ose një rezistencë ndaj penetrimit të ujit sipas ISO EN 7031 me një vlerë maksimale që nuk kalon 50 mm dhe një vlerë mesatare që nuk kalon 20 mm. Raporti ujë/çimento nuk do të kalojë 0.55.

Ujëthithja maksimale e agregateve nuk duhet të kalojë 3% (BS 6349).

Agregatet e testuara për ujëthithjen në përputhje me EN 1097-6, konsiderohen në EN 12620 si rezistente ndaj cikleve ngrirje nëse kanë një ujëthithje më të vogël se 1%. Për agregate të përdorura në struktura betoni në kushte normale dhe të testuar në përputhje me ASTM, mund ti referohemi tabelës së mëposhtme:

Tabela 6-10: Vlerat limite të ujëthithjes së agregateve të betonit (të testuara sipas ASTM C 127 dhe 128)

Tipi i agregatit	Standardi i testimit	Vlera limite e ujëthithjes (%)
I imët	ASTM C 128	$< 2.3 \%$
I trashë	ASTM C 127	$< 2.0 \%$

6.1.11.4 Dendësia

Dendësia do të përcaktohet në përputhje me EN 12390-7. Për betonet normale, dendësia e matur në gjendje të thatë në furrë duhet të jetë më e madhe se 2000 kg/m^3 dhe më e vogël se 2600 kg/m^3 , ndërsa për betonet e rënda kjo dendësi do të jetë më e madhe se 2600 kg/m^3 . Për betonet e lehta, dendësia do të jetë në përputhje me kërkesat e klasës që tregohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6-11: Klasat e dendësisë për betonet e lehta (Tab 14 - EN 206)

Klasa e dendësisë	D1,0	D1,2	D1,4	D1,6	D1,8	D2,0
Variacioni i dendësisë e testuar në përputhje me kërkesat e EN 12390-7 (kg/m^3)	≥ 800 dhe ≤ 1000	≥ 1000 dhe ≤ 1200	≥ 1200 dhe ≤ 1400	≥ 1400 dhe ≤ 1600	≥ 1600 dhe ≤ 1800	≥ 1800 dhe ≤ 2000

6.1.11.5 Rezistenca ndaj cikleve ngrirje – shkrirje

